

Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut
О.О.У. “Екрем Чабев”
Sh.F.K. “Egrem Çabej”
Дел.бр. Нг.пр. 0201 – 70 / 4
26.03.2021 Слатино/Sllatinë



VETEVALUIMI I PUNËS SË SHKOLLËS



Mars 2021

1. HYRJJE NË VETEVALUIMIN E SHKOLLËS

Vetevaluimi i shkollës është një proces i kontrollimit dhe përcjelljes së vazhdueshme, analizimit dhe vlerësimit të punëve të realizuara me të vetmin qëllim, përparimin dhe sigurimin e cilësisë në punën e shkollës. Në procedurën e vetevaluimit të shkollës kërkohet përgjigje në tre çështje kryesore:

- **Sa është e mirë shkolla jonë?**
- **Si e dimë këtë?**
- **Ç'mund ne të bëjmë që të jemi më të mire?**

Përgjigjet e këtyre pyetjeve patjetër të bazohen në të dhënat relevante dhe objektive si dhe qasjen reale në funksionimin e shkollës.

1.2. QËLLIMET E VETEVALUIMIT

- Strukturimin e sistemit të brendshëm shkollor për përcjellje, vlerësim dhe përparim të punës.
- Kyçje në procesin zhvillimor të shkollës të të gjithë subjekteve: drejtor, mësime, nxënës, prind, bashkësia vendore në sistemin edukativo-arsimor.
- Sigurimi i pavarësisë më të madhe, përgjegjësisë dhe inovimit apo sendërtimit të shkollës.
- Ndërmarrja e masave për mësim më efikas dhe më cilësor dhe me këtë, edhe arritja e rezultateve më të mira.
- Detektimi i anëve të dobta dhe problemet me të cilët ballafaqohet shkolla dhe tejkalimi i tyre.
- Rritja e ndikimit të jashtëm në lidhje me shkollën dhe të gjithë subjekteve të lidhur me punën e saj, politikën e gjithëmbarshme arsimore përmes artikullimit të qartë të nevojave për zhvillimin e shkollës.
- Definimi dhe përcjellja e indikatorëve matës dhe kriterëve matës të cilësisë së procesit arsimor-edukativ në shkollë.
- Procesi i vetevaluimit është kompleks, prandaj ai kalon në shumë faza dhe aktivitete me zbatim të metodave dhe teknikave me qëllim të krijimit të unifikimit të kriteriumeve.

2. VETEVALUIMI NË SHKOLLËN TONË FILLORE

Shkolla fillore komunale "Eqrem Çabej" - Sllatinë, në mënyrë të vazhdueshme ka pretenduar dhe po kujdeset në ngritjen e cilësisë së mësimin dhe mësime, përmirësimin e kualitetit të arsimit dhe edukimit me të arriturat e nxënësve në shkollë.

Një segment të rëndësishëm në këtë drejtim paraqet edhe diagnostifikimi i gjendjes konkrete, i cili bëhet përmes procesit të vetevaluimit të punës së shkollës fillore në përgjithësi, në të cilin aktivitetet përfshihen një numër i caktuar subjektësh: mësime, nxënës, prindër dhe përfaqësues nga MASH-i dhe BZHA - së.

Matja e kualitetit të punës së shkollës do t'iu ndihmojë drejtuesit të shkollës, mësime, nxënës, prindërit, që të vlerësojnë efektshmërinë e punës së shkollës me të gjitha sferat dhe segmentet e saj.

Ky aktivitet, përveç tjerash do të ndikojë që:

- të vlerësohet kualiteti i punës së shkollës në bazë të kriterëve të paracaktuara,
- të identifikohen sferat në të cilat është i nevojshëm intervenimi në përmirësimin e situatës apo gjendjes së caktuar,
- të aftësohet kuadri udhëheqës për marrjen e vendimeve të qëndrueshme lidhur me ruajtjen e anëve të forta dhe tejkalimin e mangësive të punës së shkollës.

Në bazë të nenit 129 dhe 130 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta zyrtare e R.M.V-së Nr.161/2019), Këshilli i shkollës me propozim të drejtorit, formon Komisionin shkollor të përbërë nga, 5 anëtarë nga radhët e mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe këshillit të prindërve, edhe atë:

- 1. Syrja Etemi bashkëpunëtor profesional - pedagog,**
- 2. Hamije Zilbehari - ndihmës drejtoreshë,**
- 3. Igballe Bahadini - mësimdhënëse e ciklit klasor,**
- 4. Lirim Salihi - arsimtar lëndor, dhe**
- 5. Blerim Neimi - anëtar i Këshillit të prindërve.**

Ky komision mban takimin e parë më 05.11.2020, dhe merr detyra konkrete për realizimin e këtij aktiviteti duke u bazuar në dokumentin për vetevaluim të punës së shkollës.

Dokumenti i përgatitur (Vetevaluimi i punës së shkollës), përgjithësisht përbëhet nga 7 kapituj (bazuar në treguesit për cilësinë e punës së shkollës - Inspektorati Shtetëror i Arsimit).

Sferat e përfshira janë:

- I. Planet dhe programet mësimore;**
- II. Arritjet e nxënësve;**
- III. Mësimi dhe mësimdhënia;**
- IV. Përkrahja e nxënësve;**
- V. Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë;**
- VI. Resurset dhe**
- VII. Udhëheqja, menaxhimi dhe krijimi i politikave të shkollës;**

2.1. FORMIMI I EKIPEVE PËR VETEVALUIM TË PUNËS SË SHKOLLËS

Nga mbledhja e Këshillit arsimor të shkollës, të mbajtur më 30.11.2020, u formuan ekipet e shkollës për vetevaluim sipas sferave, edhe atë:

1. Planet dhe programet mësimore: 1. Syrja Etemi - koordinator, 2. Luan Abdullahi (mësimdhënës) - anëtar, 3. Gajur Alimi (mësimdhënës) - anëtar, 4. Irfan Abdullahi (mësimdhënës) - anëtar, 5. Taxhedin Jonuzi (këshilli i prindërve) - anëtar;

2. Arritjet e nxënësve: 1. Emri Ajdini (mësimdhënës) - koordinator, 2. Zarije Sadiki (mësimdhënëse) - anëtare, 3. Afërdita Baftjari (mësimdhënëse) - anëtare, 4. Vjollca Xhaferi (mësimdhënëse) - anëtare, 5. Blerim Neimi (këshilli i prindërve) - anëtar;

3. Mësimi dhe mësimdhënia: 1. Igballe Behadini (mësimdhënëse) - koordinator, 2. Ivana Gallovska (mësimdhënëse) - anëtare, 3. Rexhep Misimi (mësimdhënës) - anëtar, 4. Sahit Misimi (mësimdhënës) - anëtar, 5. Bujar Jakupi (këshilli i prindërve) - anëtar;

4. Përkrahja e nxënësve: 1. Hamije Zilbehari (nd.drejtoreshë) - koordinator, 2. Enver Husmani (mësimdhënës) - anëtar, 3. Drita Mehazi (mësimdhënëse) - anëtare, 4. Shqipe Idrizi (mësimdhënëse) - anëtare, 5. Burim Baftjari (këshilli i prindërve) - anëtar;

5. Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë: 1. Zemri Idrizi (mësimdhënës) - koordinator, 2. Skender Memeti (mësimdhënës) - anëtar, 3. Hiriye Rustemi (mësimdhënëse) - anëtare, 4. Valbona Salihi (mësimdhënëse) - anëtare, 5. Nehat Memeti (këshilli i prindërve) - anëtar;

6. Resurset: 1. Behare Alimi (mësimdhënëse) - koordinator, 2. Fatime Idrizi (mësimdhënëse) - anëtare, 3. Imer Imeri (mësimdhënës) - anëtar, 4. Zeqirja Jonuzi (mësimdhënës) - anëtar, 5. Gajur Salihi (këshilli i prindërve) - anëtar;

7. Udhëheqja, menaxhimi dhe krijimi i politikave të shkollës: 1. Lirim Salihi (mësimdhënës) - koordinator, 2. Hirem Selimi (mësimdhënëse) - anëtare, 3. Arlinda Elezi (mësimdhënëse) - anëtare, 4. Merita Alimi (mësimdhënëse) - anëtare, 5. Kamber Memedi (këshilli i prindërve) - anëtar.

**3. PROCEDIMI I EKIPEVE PËR VETEVALUIM
TË PUNËS SË SHKOLLËS SIPAS SFERAVE**

**SFERA I: PLANET DHE PROGRAMET MËSIMORE
NIVELI I REALIZIMIT: SHUMË MIRË**

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave	
Dokumentat e azhurnuara	Informacionet e mbledhura
<ul style="list-style-type: none"> Organizimi dhe realizimi i planeve dhe programeve mësimore: 	<p>I.1. Realizimi i planeve dhe programeve mësimore.</p> <ul style="list-style-type: none"> Shkolla fillore komunale “Eqrem Çabej” – Sllatinë - Tearcë, punën e saj e realizon duke u mbështetur në Planet dhe programet mësimore të miratuara nga MASH-i (Ministria e Arsimit dhe Shkencës) dhe BZHA-së (Byroja për Zhvillim të Arsimit). Planet dhe programet mësimore realizohen në vëllimin e paracaktuar dhe nuk ka tendenca në shmangien ose ndryshimin e asaj që “ofrohet” dhe asaj që realizohet. Ajo gjithnjë po pretendon në informimin e nxënësve dhe prindërve në përgjithësi për qëllimet e Planeve dhe programeve mësimore që janë duke u realizuar. Përkundër disa tentimeve eventuale, shkolla nuk ka mundësi të bëjë adaptimin e Planeve dhe programeve konform karakteristikave të mjedisit lokal. Në përjashtim të mësimdhënësve, nxënësit dhe prindërit nuk kanë ndonjë qasje në azhurnimin e Planeve dhe programeve arsimore. Me këto dokumente mësimdhënësit njoftohen përmes këshillimit apo seminari të organizuar nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës apo BZHA-së dhe informimeve nga ana e shërbimit pedagogjik të shkollës etj.
<ul style="list-style-type: none"> Planet globale dhe tematike të hartuara nga ana e mësimdhënësve 	<ul style="list-style-type: none"> Mësimdhënësit rregullisht i bëjnë planifikimet (vjetore, mujore, dhe ditore), gjithnjë duke patur parasysh Planet dhe Programet e MASH-it, edhe pse disa përmbajtje nuk mund të adaptohen në kushtet ekzistuese. Të gjithë mësimdhënësit posedojnë Programe dhe Plane mësimore të MASH-it.
<ul style="list-style-type: none"> Procesverbal nga përgatitjet e kontrolluara me shkrim 	<p>I.2. Kualiteti i planeve dhe programeve mësimore</p> <ul style="list-style-type: none"> Shkolla nuk ka ndërmarë ndonjë iniciativë për ndryshimin dhe plotësimin e planprogrameve mësimore për t’iu drejtuar MASH-it, BZHA-së si dhe Qendrës për arsimim dhe trajnim profesional. Ekzistojnë modele për qasje integrative të veçorive të mjedisit lokal në një pjesë të vogël të përmbajtjeve mësimore dhe lëndëve të ndryshme mësimore.
<ul style="list-style-type: none"> Programi vjetor i punës së shkollës 	<ul style="list-style-type: none"> Në fillim të vitit shkollor, nxënësit përcaktohen për lëndën e preferuar zgjedhore (Arsim teknik, Projekte nga Arsimi figurativ), nga klasa VII, VIII dhe IX. Meqë në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2019/2020 u krijua situata e pandemisë nga Kovid 19, nuk u arritë që disa aktivitete të realizohen me sukses, sidomos anketimet e nxënësve për përcaktimin e lëndës zgjedhore për vitin e ardhshëm mësimor ku i njëjti problem u bartë edhe në vitin shkollor 2020/2021; Shkolla nuk zbaton programe të zgjeruara, apo “mikromësim” (mësim plotësues), me të cilat do të përfshiheshin të gjithë nxënësit që kanë nevojë për to, sidomos për fëmijët e diasporës.

<ul style="list-style-type: none"> • Ditarët shkollor (regjistrat) 	<p style="text-align: center;">I.3. Aktivitetet e lira (Klubet dhe seksionet)</p> <p>- Kohëve të fundit, për shkak të mbingarkesës së nxënësve me lëndë mësimore që nënkupton edhe me orë të shumta mësimore, si dhe situata e pandemisë, gjë që nxënësit nuk ndjekin mësimin me prezencë fizike (në përjashtim të klasave të para, dyta dhe të treta), këto aktivitete realizohen me shumë vështirësi, sidomos kur bëhet fjalë për disa aktivitete të lira me seksione (klube) të caktuara. Ato seksione që ekzistojnë funksionojnë me aktivitete të reduktuara për shkaqe objektive.</p> <p>Nxënësit dhe arsimtarët përfshihen në këto seksione gjatë aktiviteteve të planifikuara, si dhe me rastin e festave shkollore që organizohen manifestime të ndryshme. Është karakteristikë e evidente se në aktivitete të lira, më shumë përfshihen nxënësë sesa nxënës. Kur është fjala për pjesëmarrjen e nxënësve në to dhe afinitetin e tyre në seksione të ndryshme, mund të thuhet se nxënësit e gjinisë mashkullore më tepër priren pas aktiviteteve fizike sportive, kurse ato femërore - zgjedhin dhe dallohen në aktivitete kulturore - artistike.</p> <p>- Nga viti shkollor 2019/2020, në shkollën tonë punon edhe një edukatore speciale, nxënësit me aftësi të ndryshme ose me nevoja të veçanta kyçen në këtë paralele dhe në kuadër të aktiviteteve jashtëmësimore, ku me ata punohet me ndonjë program suplementar apo plotësues.</p> <p>- Nga kjo mënyrë e organizimit dhe realizimit të A.J.M., mundësitë janë shumë të vogla për nxitjen e aftësive kreative, intelektuale dhe shoqërore të nxënësve.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Protokole për vëzhgime dhe hospitime pedagogjike të orëve mësimore nga ana e drejtorit dhe pedagogut të shkollës 	<p>- Nga orët e përcjellura mësimore dhe konsultimet për çdo orë të realizuar, konstatohet se shumica e mësimdhënësve, objektivat dhe qëllimet arsimore të planifikuara i realizojnë në rregull. Në orë ekziston korrelacion dhe integrim të temave, veçanërisht të mësimi i ciklit klasor.</p>

V e t e v a l u i m i

Metodat e shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave (pyetësorë, anketa, vëzhgime)									
Metoda dhe teknika tjera të shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave	Subjektë të kyçur në mbledhjen e informacioneve vijuese	Informacionet e mbledhura							
<ul style="list-style-type: none"> • Anketa me shërbimin profesional dhe mësimdhënës 	Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga mësimdhënësit	- Nga ana e shërbimit pedagogjik, drejtori i shkollës dhe ndihmësdrejtoresha, mësimdhënësve u ofrohet ndihmë konsultative gjatë përgatitjes së planeve dhe programeve. - 75% e mësimdhënësve vet i hartojnë planet dhe programet mësimore (planifikimet), ndërsa 25% e tyre, këtë aktivitet e bëjnë përmes aktiveve profesionale. Për ndërtim më kualitativ të planifikimeve, mësimdhënësve u nevojitet trajnim permanent nga ana e personave profesionistë të BZHA-së dhe MASH-it.							
<ul style="list-style-type: none"> • Anketa me nxënës 	Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga nxënësit	- Nga gjithsejt: 52 nxënës të anketuar 95% e tyre mendojnë se janë të mbingarkuar me lëndë dhe orë mësimore, ndërsa 5%, nuk mendojnë kështu.							
		Nxënës	M	F	GJ	PO	%	JO	%
		s	26	26	52	49	95	3	5
<ul style="list-style-type: none"> • Bisedë me grup të nxënësve (Ba. e nxënësve) 	Informacionet janë mbledhur nga pedagogu i shkollës	- Nxënësit mendojnë se janë tepër të ngarkuar jo vetëm me orë dhe lëndë mësimore, por edhe me detyra shtëpie dhe aktivitete.							
<ul style="list-style-type: none"> • Pyetësor për prindë 	Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga prindërit	- Arsimi për luftën kundër përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogës, realizohet me qasje profesionale nga ana e punonjësve arsimor të shkollës. - Nga 52 prindë të anketuar, 85% e tyre mendojnë se shkolla përmbush kushtet dhe nevojat teknike e kadrovike, ndërsa 15% e tyre mendojnë të kundërtën. (Nuk janë të kënaqur me kushtet objektive teknike, por edhe me ato kadrovike. - Prej 52 prindërve, 80% e të anketuarve janë të kënaqur me kualitetin e mësimin dhe mësimdhënies, ndërsa 20%, nuk janë të kënaqur.							
<ul style="list-style-type: none"> • Takime individuale me prindë, nxënës dhe mësimdhënës 	Ekipi për mbledhjen e të dhënave	- Mësimdhënësit mendojnë se prindërit mund të ndikojnë në lidhje me mënyrën e realizimit të planeve dhe programeve mësimore.							

Rezultatet e përmbledhura:

Anët e forta:

- Planet dhe programet mësimore, në përgjithësi realizohen, qoftë në aspektin kuantitativ po ashtu edhe në aspektin kualitativ (duke marrë parasysh situatën e rënduar nga **Kovid-19** dhe krijimit të kushteve të mësimdhënies onllajn);
- Mësimdhënësit për çdo vit shkollor përgatisin plane dhe programe - planifikime: vjetore (globale), mujore (tematike) dhe përgatitje ditore;
- Drejtori, ndihmës drejtoresha dhe pedagogu, në mënyrë permanente bëjnë përcjelljen e kualitetit të planifikimit të punës së mësimdhënësve;
- Mësimdhënësve u jepet ndihmë konsultative gjatë hartimit të planifikimeve të mësimdhënësve (nga ana e pedagogut, drejtorit dhe ndimës drejtoreshës);
- Mësimdhënësit u japin ndihmesën e tyre nxënësve për arritjen e rezultateve më të mira.

Anët e dobta:

- Trajnim i pamjaftueshëm i disa mësimdhënësve për hartim më efikas të planeve dhe programeve mësimore dhe përshtatje më adekuate kushteve ekzistuese (situatën e rënduar nga **Kovid 19** dhe krijimit të kushteve të mësimdhënies onllajn);
- Mungesa e kushteve infrastrukturore (sallës sportive – gjatë vitit shkollor 2020/2021 kanë filluar punët për ndërtimin e sallës sportive në oborin e shkollës).

Analizë e rezultateve

Evaluim më detal i sferës: Planet dhe programet mësimore

Planet dhe programet e aplikuara mësimore janë në pajtim me dokumentat programore të MASH-it dhe të njëjtët realizohet në vëllimin e paracaktuar.

Ka disa mangësi të caktuara të disa përmbajtje mësimore, të cilat janë të vjetërruara, voluminoze dhe joadekuate për kushtet e shkollës.

Prindërit dhe nxënësit nuk njoftohen me përmbajtjet dhe lëndët e caktuara mësimore, në përjashtim të disa prindërve - në cilësi të kryesisë së Këshillit të prindërve apo Këshillit të shkollës.

Në shkollë ka fëmijë me nevoja të veçanta, dhe këta përfshihen në kuadër të mësimin të rregullt, për ata të kategorisë më të rëndë, kujdeset edukatorja rehabilituese që punon në nivel të shkollave të komunës.

Prindërit dhe nxënësit kërkojnë barazim me lëndë të rregullta mësimore dhe orë javore mësimore të të gjithë nxënësve, pa dallim përkatësie etnike e gjuhësore (shih: plani dhe programi mësimor për vitin shkollor 2020/2021 nga klasa IV – IX-të), lehtësim apo shkarkim të materialit voluminoz të përmbajtjeve nga lëndë të ndryshme mësimore, reduktim të disa lëndëve të tepërta mësimore, madje edhe të orarit të stërngarkuar mësimor, kështu, të ketë më tepër kohë të lirë, në mënyrë që të sigurohen kushte optimale për sport, rekreacion, gara shkollore, me ç'rast do të socializohen do të shoqërohen më mirë dhe do të formohen si personalitet.

Si lëndë zgjedhore nxënësit mësojnë: Krijimtari - klasat V-ta, Etika në religjione - klasat VI-ta, Përparim shëndeti dhe Edukim mjedisi - klasat VII-ta, projekte nga arti figurativ - klasat VIII-ta dhe arsim teknik - klasat IX-ta.

Nxënësit me aftësi të kufizuara (nga klasa VI – IX-të) nuk përfshihen A.L.J.M. në mënyrë të mjaftueshme, për arsye se mungojnë kapacitetet hapësinore të furnizuara me mjete adekuate për kategorinë e tillë të nxënësve.

Mungesa e mjeteve mësimore dhe hapësirat ndikojnë në zgjedhjen adekuate të lëndëve zgjedhore.

Aktivitetet e ardhshme:

Sferat prioritare të sferës së parë, të cilat mund të përfshihen në Planin zhvillimor të shkollës.

- Intervenim dhe sigurim të kushteve infrastrukturore (Sallë sportive) me qëllim të realizimit sa më efikas të planeve dhe programeve mësimore; (Gjatë përfundimit të këtij raporti kanë filluar punimet për ndërtimin e sallës sportive).
- Barazim me lëndë të rregullta mësimore dhe orë javore mësimore të të gjithë nxënësve, pa dallim përkatësie etnike e gjuhësore (shih: plan programin mësimor për vitin shkollor 2020/2021 nga klasa IV – IX-të);
- Sigurimi i trajnimit (aftësimit profesional) të disa mësimeve për një planifikim më efikas të punës mësimore në përgjithësi;
- Sigurimi i mjeteve financiare për motivimin e mësimeve dhe nxënësve për arritjen e rezultateve më të mira.

Përpunuan:

1. Syrja Etemi;
2. Luan Abdullahi;
3. Irfan Abdullahi;
4. Gajur Alimi; dhe
5. Taxhedin Jonuzi.

Vetevaluimi

II. TË ARRITURAT E NXËNËSVE

- NIVELI I REALIZIMIT: SHUMË MIRË

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave																												
Dokumentat e azhurnuara	Informacionet e mbledhura:																											
<ul style="list-style-type: none"> ● Pasqyrë statikore e suksesit të nxënësve në gjysmëvjetor dhe fundin e vitit shkollor 	<p>II.1. Të arriturat e nxënësve:</p> <p>- Në bazë të analizave të suksesit të nxënësve për çdo gjysmëvjetor dhe fundviti shkollor, nxënësit e të dy gjinive, “sukses” mesatar më të lartë arrijnë në lëndët mësimore “të shkathtësive”, pra në edukimin fizik e shëndetësor, arsim figurativ, arsim muzikor, kurse sukses më të ulët – në lëndët matematikore - natyrore dhe gjuhët e huaja, konstatim ky që nuk vlen për nxënësit e përkatësisë etnike maqedone të shkollës periferike, pasi që ata mësojnë në paralele të kombinuara, kurse mësimin në ciklin lëndor e ndjekin në shkollë tjetër (në Tearcë). Nga përcjellja e të arriturave të nxënësve në sferën e ekipit të tyre nga ana e mësimdhënësve, periodikisht na paraqitet një konfuzitet vlerësues, sepse në gjysmëvjetorin e parë suksesi është më i ulët në krahasim me fundvitin, kur materiali mësimor është më voluminoz;</p>																											
<ul style="list-style-type: none"> ● Raporte nga analiza e suksesit dhe sjelljes së nxënësve ● Ditar klasor ● Dosie të nxënësve të regjistruar në shkolla të mesme ● Procesverbal nga mbledhjet prindore 	<p>- Duke u mbështetur në pasqyrën e suksesit të përgjithshëm të nxënësve në fund të klasës V-të dhe IX-të, (sipas lëndëve, gjinisë dhe përkatësisë etnike) si dhe në testimet apo vlerësimet e ndryshme (interne ose eksterne) del një fakt i padiskutueshëm, sepse sukses më të lartë (notë mesatare më të lartë) arrijnë nxënësit e klasave të V-ta, e në veçanti nxënësit e gjinisë femërore;</p> <p>- Për çdo gjysmëvjetor të një viti shkollor, nga ana e kujdestarëve të klasave bëhet raporti i suksesit, sjelljes dhe disiplinës së nxënësve, madje për t’u përpunuar, sistemuar, sublimuar dhe publikuar nga ana e shërbimit pedagogjik në mbledhje të Këshillave të Arsimitarëve, Këshillit të Prindërve dhe Këshillit të Shkollës. Këtyre të dhënave u ndihmojnë edhe rezultatet e testeve dhe vlerësimeve interne të nxënësve sipas gjinisë, lëndëve mësimore dhe klasave të caktuara;</p> <p>- Është një konstatim i përgjithshëm që del nga analiza e suksesit të nxënësve se shumica e realizatorëve të procesit mësimor aplikojnë metodologji të ndryshme për kontrollimin, vlerësimin dhe notimin e njohurive, interesimeve dhe diturive të nxënësve.</p> <p>- Nga analiza e të arriturave të nxënësve të bëra nga kujdestarët e klasave, arsimtarëve të ciklit klasor e lëndor, madje edhe shërbimit pedagogjik, për nxënësit me nevoja të veçanta apo me vështirësi në të mësuar, rishtazi pretendohet të organizohen orë të veçanta mësimore, si që është mësimi plotësues.</p> <table border="1" data-bbox="606 1780 1372 2004"> <thead> <tr> <th rowspan="2"></th> <th colspan="2">Nota mesatare</th> <th colspan="3">% e nx. me l</th> </tr> <tr> <th>IV</th> <th>V</th> <th>VI-IX</th> <th>IV-IX</th> <th></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Gj.vj. I</td> <td>3.8 0</td> <td>3.9 0</td> <td>3.70</td> <td>3.80</td> <td>18% nx.me l</td> </tr> <tr> <td>Gj.vj. II</td> <td>3.9 7</td> <td>4.0 0</td> <td>3.84</td> <td>3.91</td> <td>0%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga analiza del se disa mësimdhënës aplikojnë metodologji të mirëfilltë për vlerësimin e njohurive dhe diturive të nxënësve.</p>						Nota mesatare		% e nx. me l			IV	V	VI-IX	IV-IX		Gj.vj. I	3.8 0	3.9 0	3.70	3.80	18% nx.me l	Gj.vj. II	3.9 7	4.0 0	3.84	3.91	0%
	Nota mesatare		% e nx. me l																									
	IV	V	VI-IX	IV-IX																								
Gj.vj. I	3.8 0	3.9 0	3.70	3.80	18% nx.me l																							
Gj.vj. II	3.9 7	4.0 0	3.84	3.91	0%																							

V e t e v a l u i m i

	<ul style="list-style-type: none"> - Për çdo vit, sukses më të lartë shënohet në ciklin klasor; - Në gjysmëvjetor (viti shkollor 2019-2020) ka 18% e nxënësve me të dobëta, kurse në fund të vitit nuk ka asnjë nxënës me të dobëta; - Nga numri i përgjithshëm i nxënësve që mbarojnë klasën IX, 100% e tyre vazhdojnë në shkollimin e mesëm;
<ul style="list-style-type: none"> ● Raporte të rezultateve nga garat e realizuara 	<p>Nxënësit e shkollës sonë gjatë katër viteve të fundit, marrin pjesë në të gjitha garat komunale, rajonale dhe shtetërore në të gjitha lëndët dhe aktivitetet që organizohen në artet e ndryshme, futboll, matematikë, letërsi, shkencë etj. Në garat që përmendëm nxënësit e shkollës kanë arritur rezultate të mira. Poashtu, nga raportet e fituara nga shërbimet pedagogjike të shkollave të mesme, nxënësit e shkollës sonë tregojnë suksese po ashtu të dalluara.</p>
<ul style="list-style-type: none"> ● Ditar klasor ● Libra amë ● Fletëshpërngulje ● Procesverbale nga Bashkësia e nxënësve ● Komisioni për regjistrim të fëmijëve në kllasë e parë (I-rë) (viti shkollor 2019-2020 dhe 2020-2021) 	<p style="text-align: center;">II.2. Shkapërderdhja (shpërndarja) e nxënësve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gati qind përqind e nxënësve (që nga klasat e I - IX-të) e mbarojnë shkollimin fillor, duke përjashtuar këtu disa nxënës (1%) në vjet që migrojnë në shtetet e jashtme; - Në shkollë nuk ka grupe të identifikuar nxënësish (meshkuj apo femra, nga ndonjë përkatësi të caktuar etnike, nxënës nga kategori të ndryshme sociale etj.) që do të motivonin “shkapërderdhjen” e tyre. - Në listat për regjistrim të fëmijëve në klasën e I (parë), 20 - 30% gjenden me familje në migracion; - Shkolla brenda mundësive që ka, ku përmes fondeve sociale të klasave të caktuara, donacioneve të ndryshme me karakter humanitar, mundohet t’iu dalë në ndihmë nxënësve të kategorisë sociale dhe ekonomike. Për këtë është më se e domosdoshme përkrahja institucionale e shtetit.

V e t e v a l u i m i

Metodat dhe teknikat e shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave (pyetësorë, anketa, vëzhgime)																							
Metoda dhe teknika tjera të shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave	Subjektë të kyçur në mbledhjen e Informacioneve e vijuese	Informacionet e mbledhura																					
<ul style="list-style-type: none"> ● Anketa me mësimdhënës 	<p style="text-align: center;">Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga mësimdhënësit</p>	<p>Nga 40 mësimdhënës të anketuar të shkollës (25 M. dhe 15 F.), 80% e tyre mendojnë se të gjithë nxënësit nuk tregojnë rezultate të suksesshme, për arsye se prindërit e tyre nuk interesohen sa duhet për fëmijët e tyre në shkollës, ndërsa 20% e tyre mendojnë se të gjithë nxënësit arrijnë rezultate të mira.</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; margin-top: 10px;"> <thead> <tr> <th style="text-align: left;">Mësimdhënës</th> <th>M</th> <th>F</th> <th>GJ</th> <th>PO</th> <th>%</th> <th>J O</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">25</td> <td style="text-align: center;">15</td> <td style="text-align: center;">40</td> <td style="text-align: center;">8</td> <td style="text-align: center;">20</td> <td style="text-align: center;">32</td> <td style="text-align: center;">80</td> </tr> </tbody> </table>						Mësimdhënës	M	F	GJ	PO	%	J O	%		25	15	40	8	20	32	80
Mësimdhënës	M	F	GJ	PO	%	J O	%																
	25	15	40	8	20	32	80																
<ul style="list-style-type: none"> ● Anketa me nxënës 	<p style="text-align: center;">Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga nxënësit</p>	<p>Nga gjithsejt: 52 nxënës të anketuar 26 M dhe 26 F (nga klasa VI - IX), prej tyre (70%) janë të kënaqur me rezultatet e arritura në shkollë, ndërsa (30%), nuk janë të kënaqur.</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; margin-top: 10px;"> <thead> <tr> <th style="text-align: left;">Nxënës</th> <th>M</th> <th>F</th> <th>GJ</th> <th>PO</th> <th>%</th> <th>J O</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">26</td> <td style="text-align: center;">26</td> <td style="text-align: center;">52</td> <td style="text-align: center;">36</td> <td style="text-align: center;">70</td> <td style="text-align: center;">16</td> <td style="text-align: center;">30</td> </tr> </tbody> </table>						Nxënës	M	F	GJ	PO	%	J O	%		26	26	52	36	70	16	30
Nxënës	M	F	GJ	PO	%	J O	%																
	26	26	52	36	70	16	30																
<ul style="list-style-type: none"> ● Pyetësor për prindë 	<p style="text-align: center;">Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga prindërit</p>	<p>- Nga 52 prindë të anketuar (të fëmijëve të shkollës qendrore dhe periferike), 75% e tyre janë të kënaqur me rezultatet e fëmijëve të tyre në shkollës, ndërsa 25% e tyre mendojnë të kundërtën.</p> <p>- Prej të anketuarve, 80% prindërve janë të kënaqur me kualitetin e mësimin dhe mësimdhënies, ndërsa 20% e prindërve nuk janë të kënaqur.</p>																					
<ul style="list-style-type: none"> ● Takime individuale me prindë, nxënës dhe mësimdhënës ● Bisedë me drejtorin e shkollës, pedagogun ● Azhurnim i raportit nga ana e IRA dhe NJR të BZHA-Tetovë 	<p style="text-align: center;">Ekipi për mbledhjen e të dhënave</p>	<p>Mësimdhënësit mendojnë se prindërit mund të ndikojnë në lidhje me mënyrën e realizimit të planeve dhe programeve mësimore.</p> <p>Një numër i caktuar prindërisht (përfaqësues nga Këshilli i Prindërve të shkollës), mendojnë se mësimdhënësit e papërgatitur për orë mësimore, madje edhe ata të cilët nuk aftësohen për trendet e kohës (nuk posedojnë standarde pedagogjike), paraqesin mbingarkesë për nxënësit.</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; margin-top: 10px;"> <thead> <tr> <th style="text-align: left;">Prindë</th> <th>GJ</th> <th>PO</th> <th>%</th> <th>JO</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">52</td> <td style="text-align: center;">34</td> <td style="text-align: center;">65</td> <td style="text-align: center;">15</td> <td style="text-align: center;">35</td> </tr> </tbody> </table> <p>60% e prindërve mendojnë se fëmijët e tyre nuk arrijnë rezultate të mira për shkak se ata nuk bashkëpunojnë sa duhet me shkollën, dhe konfirmojnë se trekëndëshi pedagogjik: prindë – shkollë - nxënës nuk funksionon sa dhe si duhet.</p> <p>- Drejtori, këshilltarët pedagogjikë, përfaqësues të inspektoratit për arsim dhe pedagogu i shkollës, në bazë të numrit të caktuar të hospitimeve pedagogjike, konstatojnë se 80% e këtyre orëve mësimore rezultojnë të suksesshme, ndërsa 20% nuk realizohen sipas standardeve pedagogjike.</p>						Prindë	GJ	PO	%	JO	%		52	34	65	15	35				
Prindë	GJ	PO	%	JO	%																		
	52	34	65	15	35																		

Rezultatet e përmbledhura:

Anët e forta:

- Shkolla disponon me të dhëna për rezultatet dhe arritjet e nxënësve sipas përkatësisë gjinore dhe etnike, për të gjitha lëndët mësimore dhe periudhat;
- Shkolla krijon bindjen se suksesi i nxënësve (të arriturat) mund të përmirësohen dhe se sipas pasqyrës së suksesit të arritur të nxënësve (të fituara përmes testimeve dhe vlerësimeve me gojë e me shkrim), shkolla herë - herë ndërmerr aktivitete për përmirësimin e suksesit;
- Shkolla identifikon nxënësit e talentuar, me vështirësi në mësim dhe ata me nevoja të veçanta, dhe pretendon në ndërtimin e një strategjie më efikase për punën me këto kategori;
- Një numër i caktuar i mësimdhënësve në procesin e rregullt mësimor, mbështesin nxënësit e lartpërmendur duke realizur orë nga mësimi shtesë dhe plotësues (edhe atë në disa lëmi të caktuara);
- Mësimdhënësit u japin ndihmesën e tyre nxënësve, për arritjen e rezultateve sa më të mira.

Anët e dobta:

- Disa mësimdhënës me vështirësi pranojnë dhe implementojnë inovacionet, madje format dhe metodat e reja të mësimit dhe mësimdhënies;
- Përfshirje të pamjaftueshme të prindërve dhe nxënësve në vlerësimin e të arriturave të vet nxënësve;
- Mospërfshirja e të gjithë mësimdhënësve në punën me nxënësit me nevoja të veçanta, nxënës me probleme në mësim dhe nxënës të talentuar.

Analizë e rezultateve:

Evaluum më detal i sferës: Arritjet e nxënësve

Rezultatet dhe të arriturat e nxënësve synohen të arrihen përmes intervenimeve në përmirësimin e infrastrukturës së shkollës, sigurimit të mjeteve e pajisjeve mësimore, kuadrit adekuat dhe tendencave për implementimin e inovacioneve në punën mësimore. Të gjithë subjektët të cilët në mënyrë direkte dhe indirekte janë të impenjuar në punën edukativo-arsimore, nuk janë aq koherentë, sepse mungon mbështetja nga ana e numrit të madh të prindërve. Një numër i konsiderueshëm i prindërve janë të kënaqur me suksesin e arritur të nxënësve, të cilët arrijnë rezultate relativisht të mira edhe në shkolla të mesme. Nga mbikëqyrja, përcjellja dhe kontrollimi i rrjedhës së punës mësimore, 20% e orëve mësimore nuk realizohen sipas standardeve pedagogjike.

Aktivitetet e ardhshme:

Objektivat prioritarë të sferës së dytë, të cilat mund të përfshihen në Planin zhvillimor të shkollës

- Intervenim në infrastrukturën e shkollës (qendrore dhe periferike);
- Shpërblimi i nxënësve dhe mësimit të suksesshëm që arrijnë suksese dhe rezultate të mira dhe përmirësimi dhe motivimi i prindërve për një kooperim më të madh me shkollën;
- Sigurimi i trajnimit (aftësimi profesional) të arsimtarëve për dhënien e ndihmës profesionale fëmijëve me nevojë të veçanta dhe mbajtja e trajnimeve, seminareve me mësimit të aplikimit të metodologjisë bashkëkohore për vlerësimin dhe noEkipin e nxënësve;
- Krijimi i kushteve për realizimin e mësimit kabinetik në shkollë.

Përpunuan:

1. Emri Ajdini (mësimit të suksesshëm) - koordinator,
2. Zarije Sadiki (mësimit të suksesshëm) - anëtare,
3. Afërdita Baftjari (mësimit të suksesshëm) - anëtare,
4. Vjollca Xhaferi (mësimit të suksesshëm) - anëtare,
5. Blerim Neimi (këshilli i prindërve) - anëtar;

III. MËSIMI DHE MËSIMNXËNIA

- NIVELI I REALIZIMIT: SHUMË MIRË

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave	
Dokumentat e azhurnuara	Informacionet e mbledhura:
<ul style="list-style-type: none"> • Programi vjetor i punës së shkollës • Planet dhe programet e miratuara nga ana e MASH-it dhe BZHA-së • Planet dhe programet e përgatitura nga mësimitdhënësit • Raporte vjetore për punën e shkollës të përgatitur nga ana e shkollës • Ditar për punën konsultative – këshillëdhënëse nga ana e udhëheqësisë së shkollës 	<p>III.1. Planifikimi i mësimitdhënësve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për çdo vit mësimor, drejtori i shkollës me ekipin punues të shkollës dhe pedagogut e shkollës, përgatitë Program vjetor për punën e shkollës. - Për realizimin e planeve dhe programeve mësimore (planifikimeve), mësimitdhënësit përgatisin dhe hartojnë plane globale, tematike (periodike) dhe operative; - Përveç planeve të lartëpërmendura, arsimtarëve bëjnë edhe planifikime ditore (konspekte ditore me shkrim), ku pedagogu i shkollës, drejtori dhe ndihmës drejtoresha, kanë ndërtuar sistem të organizuar për përcjelljen e planifikimeve të arsimtarëve; - Në nivel të aktiveve profesionale, dhe nivel të shërbimit pedagogjik (përmes këshillimeve, sugjerimeve e punëtorive metodike), realizimit të seminareve nga ana e MASH-it (Ministritsë së Arsimit dhe Shkencës), BZHA-së (Byrosë për Zhvillimin e Arsimit), etj., shkolla jep ndihmesë në ngritjen dhe efikasitetin e planifikimeve dhe realizimit të mirëfilltë të punës mësimore, por është e nevojshme trajnimi periodik për këtë qëllim; - Për këmbimin e përvojave dhe informacioneve në lidhje me planifikimet e mësimitdhënësve, përdoren metodat e bashkëbisedimit, konsultimit, punëve praktike, shfrytëzimit të literaturës profesionale, metodike - didaktike.
<ul style="list-style-type: none"> • Ftesa nga seminarët nga ana e subjekteve të ndryshëm arsimor • Protokole për vlerësimin e orëve mësimore nga ana e drejtorit dhe pedagogut të shkollës • Proçesverbale nga përgatitjet ditore të arsimtarëve të kontrolluara nga ana e shërbimit pedagogjik 	<p>III.2. Proçesi mësimor</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në shkollë, gjejnë zbatim <u>përdorimi formave</u> të ndryshme mësimore, si puna në grupe, ligjërimi, puna individuale, aktivitetet praktike, shfrytëzimi i resurseve (mjeteve dhe materialeve didaktike), ku në masë të vogël përdoren format klasike me <u>primesa të një skollastike të vjetëruar të mësimitdhënies</u>; metodat dhe format mësimore (duke përfshirë këtu edhe përfshirjen dhe përdorimin e Teknologjisë së informimit dhe të komunikimit në mësim (TIK-ut), që i përdorin mësimitdhënësit), - Relativisht, mësimitdhënësit përdorin metoda të ndryshme interaksionale të mësimitdhënies, si psh: parashtrim pyetjesh, diskutim, mësim i individualizuar me nxënësit, por si <u>metodë dominante është ajo e ligjëritimit</u> nga ana e arsimtarit dhe <u>forma dialoge</u>, dhe njeherit i kushtohet rëndësi të mësuarit logjik, problemor dhe kreativ. - Nga hospitimet e realizuara, nga vëzhgimet hulumtuese dhe përcjellja A.L., madje edhe nga të dhënat e sublimuara nga anketimet e nxënësve dhe mësimitdhënësve, fitohet përshtypja se nxënësit e gjinisë femërore më tepër angazhohen në aktivitete të ndryshme mësimore. Prandaj, për këtë dukuri nevojitet një hulumtim apo studim më i thellë profesional, si në aspektin pedagogjik, po ashtu edhe në atë psikologjik e social.

<ul style="list-style-type: none"> ● Protokole për vlerësimin e orëve mësimore nga ana e drejtorit dhe pedagogut të shkollës ● Proçesverbale nga përgatitjet ditore të arsimtarëve të kontrolluara nga ana e shërbimit pedagogjik ● Proçesverbale nga përcjellja e realizimit të A.L.M. dhe A.J.N. 	<p style="text-align: center;">III.3. Përvoja e nxënësve në mësim</p> <p>- Në përgjithësi format stimuluese dhe motivuese të nxënësve, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, gjinore, sociale e kulturore dhe stilet e ndryshme të të mësuarit, këtë aktivitet shkolla e realizon për nxënësit e shkëlqyeshëm e të dalluar në sjellje - duke dhuruar lëvdata dhe libra. Këtë aktivitet e bën edhe me shpalljen e nxënësit të dalluar të gjeneratës, (dikur: shpërblimin e punëtorit arsimor me 20 vjet përvojë pune në arsim), etj. Në mungesë të mjeteve financiare, shkolla <u>nuk ka mundësi të shpërblejë nxënësit dhe punëtorët e dalluar arsimor me ndonjë stimulim në të holla, apo të themi pushim rekreativ: (Pushim 5 apo 10 ditësh në ndonjë vend turistik)!</u></p> <p>Për këtë arsye, nxënësit shembullorë dhe të shkëlqyeshëm, stimulohen me <u>mirënjohje dhe libra:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit bëjnë ekspozimin e punimeve dhe kontributeve të ndryshme të tyre. Ka raste kur punime të nxënësve (tregime, vjersha, këngë nga folklori burimor, hartime më të bukura, madje kontribute dhe shkrime tjera me vlera artistike edhe të arsimtarëve të prirur për shkrime, të botohen dhe publikohen në periodikun e shkollës, në manifestimet e organizuara nga ana e Bibliotekës amë - Tetovë dhe Këndit amerikan – Tetovë, Ditën e Kursimit në nivel republikan, Ditën e Sigurimit në nivel republican, Dita e Tokës në nivel komunal etj. - Në mungesë të mjeteve financiare, shkolla krahas <u>botimit të gazetës së shkollës, nuk ka mundësi të bëjë etablimin e radios shkollore</u>, edhe pse për këtë ekzistojnë potenciale dhe kapacitete profesionale. Për këtë qëllim, nga viti shkollor 2019/2020, shkolla ka hapur web - faqen zyrtare (shfkeqremcabej.edu.mk), që e udhëheq arsimtari i gjuhës shqipe, Lirim Salihi. - Nxënësve, edhe pse me shumë vështirësi u krijohet mundësia që në njëfarë mënyre të ndërmarrin vetiniciativa të ndryshme të të shprehurit e mendimin kritik dhe në mënyrë aktive të kyçen në mësim etj, gjë që bëhet nëpërmjet orëve të kujdestarisë (klasës), bashkësisë së nxënësve (Parlamentit të nxënësve), sidomos ato të klasave VIII-ta dhe IX-ta. Për këtë qëllim është zgjedhur kryetare e Parlamentit të nxënësve të shkollës, Medina Sulejmani, e cila do të përfaqësojë nxënësit e shkollës sonë. - Kur bëhet fjalë për vlerësimin e punës së mësimdhënësve, mund të themi se shkolla nuk ka ndonjë instrument adekuat për këtë qëllim. - Një formë e vlerësimit të kësaj komponente mund të merret përcjellja e punës së mësimdhënësit përmes hospitimeve nga ana e pedagogut të shkollës, drejtorit, këshilltarëve pedagogjik, madje sukcesi i arritur i nxënësve në lëndë të caktuara mësimore, pjesëmarrja e nxënësve në gara dhe rezultatet e arritura në këtë segment. Prandaj, për këtë qëllim është i nevojshëm vlerësimi i brendshëm dhe ai i jashtëm i punës së shkollës.
	<p style="text-align: center;">III.4. Përmbushja e nevojave të nxënësve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Numri më i madh i prindërve janë të interesuar për rezultate më efikase dhe suksese në mësim; - Në njëfarë mënyre, mësimdhënësit identifikojnë nevojat arsimore të nxënësve përmes bashkëbisedimeve, anketave,

V e t e v a l u i m i

<ul style="list-style-type: none"> ● Proçesverbale nga analiza e suksesit të arritur të nxënësve 	<p>ushtrimeve me gojë e me shkrim, përmes bashkëpunimit me prindë dhe shërbimin pedagogjik të shkollës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësimdhënësve u jepet ndihmë morale dhe profesionale (nga shërbimi profesional i shkollës), për plotësimin apo përmbushjen e nevojave individuale arsimore të nxënësve. I'u ndihmohet në identifikimin e nxënësve të talentuar për të cilët pretendohet që përveç angazhimit në mësimin e rregullt (të detyrueshëm) të përfshihen dhe angazhohen edhe aktivitete dhe detyra të veçanta në kuadër të mësimin shtesë (M.SH) si dhe me detyra (shtëpie apo plotësuese), me qëllim të aftësimit për arritjen e rezultateve sa më solide në gara të ndryshme shkollore, komunale, regjionale apo republikane; - Mënyrat më të shpeshta që zbatojnë mësimdhënësit për sigurimin apo përfshirjen e nxënësve në aktivitete të ndryshme konform nevojave dhe stileve të të nxënësve, janë këto që i përmendëm edhe në konfirmimin paraprak. Meqë në shkollë nuk është i kompletuar shërbimi psikologjiko - pedagogjik, i cili do të punonte në mënyrën më adekuate me këta nxënës (të talentuar dhe me nxënës me nevoja të veçanta), për këtë qëllim edhe rezultatet në këtë drejtim nuk janë për t'u kënaqur; - Meqë në shkollën tonë mësimi zhvillohet në dy gjuhë, në gjuhën shqipe (në shkollën qendrore dhe në gjuhën shqipe dhe maqedone në shkollën periferike), vlerësimi dhe kujdesi për nxënësit bëhet pa ardhur në shprehje dallimet në baza lokale dhe etnike.
<ul style="list-style-type: none"> ● Proçesverbal nga Këshilli i prindërve dhe takimet me 	<p style="text-align: center;">III.5. Notimi si pjesë (segment) i mësimin</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për notimin dhe vlerësimin e përparimit të nxënësve dominante janë format dhe metodat e mirëfillta arsimore. - Aplikohet notimi numerik (nga 1 - 5), duke u bazuar edhe në Rregulloren për notim të nxënësve. Në bazë të praktikës së gjertanishme (duke përcjellur punën e mësimdhënësve në sferën e vlerësimit dhe notimit të nxënësve), ndodh që të përdoren metodat dhe format e notimit në bazë të pyetjeve - përgjigjeve të nxënësve (formë individuale), notimi në bazë të punimeve me shkrim të nxënësve (hartime, teste) etj; - Shkolla kohëve të fundit <u>ka ndërtuar kriteriume vlerësimi apo STANDARDE</u> për vlerësimin dhe notimin e nxënësve të shkollës për të cilën shkruajmë. "Kriteriumet" për notimin e nxënësve, arsimtarët i caktojnë vet duke u bazuar në standardet e lartëshënuara.
<ul style="list-style-type: none"> ● Raporte nga analiza e suksesit dhe sjelljes së nxënësve 	<p style="text-align: center;">III.6. Informimi për përparimin e nxënësve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për përparimin e tyre, nxënësit marrin informacione gojore dhe me shkrim nga mësimdhënësit e lëndës përkatëse, por edhe nga kujdestari apo udhëheqësi i paraleles (në ciklin lëndor); - Për përparimin e nxënësve, prindët marrin informacione gojore nga kujdestarët e klasave, si në kuadër të mbledhjeve prindore (që organizohen, zakonisht 4 herë në vjet), po ashtu edhe në takime individuale. Ndodh që informacione (nga ana e mësimdhënësve) të jepen edhe përmes e-mailit apo telefonit. Përveç kësaj, informacione jepen edhe me shkrim, përkatësisht: Vërtetim notash, Librezë notash, Njoftim notash, Portofol etj. (të lëshuara nga ana e

V e t e v a l u i m i

	<p>shkollës). Në tremujorin e parë të vitit shkollor 2020/2021 dhe gjysmëvjetor notimi i nxënësve dhe informimi i prindërve u realizua në formën onllajn;</p> <p>- Pyetjeve apo interesimeve të prindërve për përparimin e fëmijëve të tyre në mësim, shkolla u përgjigjet përmes takimeve të organizuara që mund të jenë individuale, grupe apo kolektive dhe me pjesëmarrjen aktive të organeve dhe shërbimit të shkollës në ato takime.</p>
--	--

Metoda dhe teknika tjera të shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave	Subjektë të kyçur në mbledhjen e informacioneve vijuese	Informacionet e mbledhura								
<ul style="list-style-type: none"> ● Anketa me nxënës 	<p style="text-align: center;">Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga nxënësit</p>	<p>Nga gjithsejt 52 nxënës të anketuar të klasës së VIII-të dhe IX-të (26 M. dhe 26 F.) në pyetjen: Sa jeni të kënaqur me përgatitjen arsimtarëve për orë mësimore? 80% e të anketuarve deklarohen me “Të kënaqur”, ndërsa 20% - me “Jo të kënaqur”.</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th>Nxënës</th> <th>Gj.</th> <th>Të kënaqur</th> <th>Të pakënaqur</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">52</td> <td style="text-align: center;">42 - 80%</td> <td style="text-align: center;">10 - 20%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në pyetjen: Cila është lënda mësimore më e dashur? Nga gjithsejt 52 nxënës dhe nxënëse, 40% e tyre deklarohen për ed.fizik dhe shëndetësor, 35% për lëndën e gj.amtare, 15% për gj.angleze.</p> <p>Nxënësit janë shumë të kënaqur me publikimin e kontributeve të tyre në gazete muri dhe në gazetën shkollore e cila botohet nga viti 2018.</p>	Nxënës	Gj.	Të kënaqur	Të pakënaqur		52	42 - 80%	10 - 20%
Nxënës	Gj.	Të kënaqur	Të pakënaqur							
	52	42 - 80%	10 - 20%							
<ul style="list-style-type: none"> ● Anketa me nxënës 	<p style="text-align: center;">Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga nxënësit</p>	<p>Nga gjithsejt 52 prindë të anketuar, 25 % e tyre “Nuk janë të kënaqur” me punën mësimore të mësimeve, ndërsa 75% janë “Të kënaqur”.</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th>Prindë</th> <th>Gj.</th> <th>Të kënaqur</th> <th>Të pakënaqur</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">52</td> <td style="text-align: center;">41 - 75%</td> <td style="text-align: center;">11 -25 %</td> </tr> </tbody> </table> <p>Përkundër 30% nga prindërit të cilët deklarohen se mund t’u ndihmojnë fëmijëve të tyre në mësim, 70% prej tyre nuk kanë mundësi t’u ndihmojnë.</p> <p>Nga gjithsejt 52 prindë të anketuar, 25% e tyre mendojnë se fëmijët e tyre nuk notohen në mënyrë objektive, ndërsa 75% mendojnë se notimi nga ana e mësimeve bëhet në mënyrë objektive.</p> <p>Nga 52 prindë të anketuar, 85% janë “Të kënaqur” me mënyrën e informimit të tyre me suksesin dhe të arriturat e nxënësve, ndërsa 15% nuk janë “Të kënaqur”.</p>	Prindë	Gj.	Të kënaqur	Të pakënaqur		52	41 - 75%	11 -25 %
Prindë	Gj.	Të kënaqur	Të pakënaqur							
	52	41 - 75%	11 -25 %							

Rezultatet e përmbledhura:

Anët e forta:

- Mësimdhënësit për çdo vit mësimor përgatisin plane globale, mujore dhe tematike si dhe planifikime për realizimin e mësimin;
- Orët mësimore realizohen përmes zbatimit të elementeve individuale dhe here-herë edhe të aplikimit të formës së punës në grupe, sidomos ato përmbajtje me Programet e adaptuara të Kembrixhit;
- Nga marsi i vitit të kaluar mësimor (2019/2020) shkolla realizon mësimin onllajn, ku 98 % e nxënësve ndjekin këtë formë të mësimin;
- Për vlerësimin e njohurive dhe diturive të nxënësve, shfrytëzohen testimet interne për të arriturat në mësim;
- Shkolla ka dispozita interne për ndjekjen e procesit mësimor dhe këto zbatohen rregullisht, ndërsa mësimdhënësin e vizitojnë në orë drejtori dhe shërbimi profesional së paku dy herë në një gjysmëvjetor, me ç'rast rezultatet e ndjekjes së punës shfrytëzohen për përmirësimin e procesit mësimor;
- Shkolla rregullisht pretendon t'i informojë prindërit për rezultatet e fëmijëve të tyre në mësim.

Anët e dobta:

- Angazhim jo i mjaftueshëm për identifikimin e nevojave arsimore të nxënësve;
- Mungesa e instrumenteve apo kriteriumeve për notim të nxënësve me aftësi të ndryshme;
- Mospërfshirja qind përqind e nxënësve në mësimin onllajn.

Analizë e rezultateve

Evaluum më detal i sferës: Mësimi dhe mësimnxënia

Mësimdhënësit përgatisin planet dhe programet globale, tematike dhe ditore për orë mësimore, duke i kushtuar vëmendje të veçantë qëllimeve edukative, arsimore dhe funksionale. Planet dhe programet e përgatitura, si dhe puna e mësimdhënësve përcillet dhe kontrollohet nga ana e shërbimit pedagogjik dhe drejtorit të shkollës. Shkolla jonë bashkëpunon me shkollat e komunës dhe më gjërë. Ka bashkëpunim permanent me prindërit edhe pse një numër i konsiderueshëm i tyre nuk janë të interesuar aq sa duhet për kushtet e mësimin të fëmijëve të tyre.

Mësimdhënësit në mënyrë të barabartë i trajtojnë nxënësit, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, gjinore dhe sociale.

Rezultatet dhe sukseset në mësim prezentohen në Tabelën reprezentative dhe faqen zyrtare të shkollës, ndërsa prindërit informohen përmes takimeve individuale dhe grupore, por edhe përmes telefonit. Nga 52 prindë të anketuar, 85% e tyre janë të kënaqur me mënyrën e informimit të tyre me rezultatet e arritura në mësim, ndërsa 15% nuk janë të kënaqur, kurse mbi 90% e tyre deklarohen se fëmijët e tyre nuk e kanë të organizuar kohën e lirë. Të gjithë subjektët e kyçur në punën e shkollës konsiderojnë se me një bashkëpunim më koherent dhe më intensive ndërmjet mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve, do të rritet edhe efikasiteti i mësimin dhe nxënies.

Aktivitetet e ardhshme:
**Objektivat prioritare të sferës së tretë, të cilat mund të përfshihen
në Planin zhvillimor të shkollës:**

- Trajnim i mësimeve për një qasje më efektive të planeve dhe programeve dhe për përmirësimin e metodologjisë së planifikimit të mësimit. Shpërblimi i nxënësve dhe mësimeve që arrijnë suksese dhe rezultate të mira dhe përmirësimi dhe motivimi i prindërve për një kooperim më të madh me shkollën;
- Ndërtimi i kriteriumeve më fleksibile për vlerësim apo STANDARDE për vlerësimin dhe notimin e nxënësve të shkollës;
- Hartimi i një strategjie të përbashkët për përfshirjen e të gjithë nxënësve në mësimin onllajn.

Përpunuan:

1. Igballe Behadini (mësimeve) - koordinatore,
2. Ivana Gallovska (mësimeve) - anëtare,
3. Rexhep Misimi (mësimeve) - anëtar,
4. Sahit Misimi (mësimeve) - anëtar, dhe
5. Bujar Jakupi (këshilli i prindërve) – anëtar.

FERA: IV. PËRKRAHJA (mbështetja) e nxënësve NIVELI I REALIZIMIT: SHUMË MIRË

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave	
Dokumentat e azhurnuara	Informacionet e mbledhura:
<ul style="list-style-type: none"> ● Plani dhe programi i punës së shkollës ● Ditarët shkollor (regjistrat) ● Plani dhe programi i aktiveve profesionale ● Procesverbal nga Këshillat arsimorë ● Plani dhe programi i pedagogut të shkollës 	<p style="text-align: center;">IV. 1. Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Format dhe aktivitetet e nduarnduarta të cilat shfrytëzohen për sigurimin e kujdesit, mirëqenies dhe mbrojtjes së fëmijve meshkuj dhe femra, duke përfshirë këtu edhe ata me nevoja të veçanta, relativisht janë efektive, pasi që për çdo fillimviti mësimor, shkolla angazhohet për sigurimin e kushteve elementare objektive për realizimin e punës edukativo - arsimore, sigurimin e kuadrit adekuat, punën edhe më kooperative të shërbimit pedagogjik; - Shkolla me shërbimin pedagogjik, në bashkëpunim koherent me mësimdhënësit e ciklit klasor, në përgatitjen për fillim e vitit të ri shkollor, përkatësisht në muajn (maj - qershor), bën regjistrimin e fëmijëve për në shkollë, ku identifikohen dhe vlerësohen zhvillimet emocionale, sociale, fizike e intelektuale të fëmijëve. Në bazë të mundësive ligjore, kadrovike dhe profesionale, shkolla pretendon të punojë në drejtim të përmbushjes së kërkesave dhe nevojave të nxënësve; - Për ata nxënës tek të cilët dyshohet se janë të abuzuar mentalisht apo fizikisht, informimi bëhet gojarisht dhe me shkrim. Informohen prindët, madje edhe udhëheqësia e shkollës. Por, ka raste edhe kur këto raste nuk mund të zbulohen. Prandaj, është e nevojshme kompletimi i ekipit profesional me specialistë të tipit: psikolog, defektolog, sociolog, jurist; - Shkolla, mundësisht tenton të bashkëpunojë me subjektë tjerë që merren me këtë problematikë, si: Qendrën sociale - Tetovë, Shkollat speciale të rajonit, kurse me ndonjë agjencion të jashtëm për ndihmë këtyre fëmijëve me nevoja të posaçme nuk na është ofruar.
<ul style="list-style-type: none"> ● Plani dhe programi i pedagogut të shkollës ● Procesverbal nga mbledhjet e Këshillit të Arsimitarëve ● Ditarë shkollor 	<p style="text-align: center;">IV.2. Shëndeti</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga realizimi i aktivitetit në zbulimin dhe verifikimin e aftësive dhe zhvillimeve intelektuale, emocionale dhe psiko-fizike të fëmijëve përmes testimeve të standardizuara të realizuara nga ana e pedagogut të shkollës, fitohen të dhëna objektive për gjendjen dhe karakteristikat e çdo fëmije; - Nxënësit e identifikuar me dëmtime eventuale psiko - emocionale, nga mungesa e mjeteve materiale e prindërve dhe mungesa e informacionit të tyre në lidhje me infrastrukturën ligjore që ka të bëjë me të Drejtat e fëmijëve, shkolla i kyç në mësimin e rregullt, duke u kushtuar kujdes të posaçëm atyre për të mos rënë pre e mentalitetit të ulët të disa moshatarëve që rrjedhin nga familjet disfunktionale të mjedisit. Fëmijë të këtyre, thuajse për çdo gjeneratë ka nga një apo dy, prandaj është e nevojshme dhe e domosdoshme <u>hapja e ndonjë qendre profesionale</u> në nivel të Komunës së Tearcës (nga ekipe të kompletuara si: sociolog, logoped, neuropsikiatër, traumatolog), ku fëmijët e kësaj kategorie do të trajtohen në mënyrë adekuate dhe sistematike; - Meqë shkolla për çdo vit bën kontrollimin sistematik mjekësor të nxënësve, për çdo rast të diagnostifikimit të ndonjë sëmundjeje apo deformimi shëndetësor të ndonjë nxënësi, shkolla bashkërisht edhe prindi informohen për të dhe i cili udhëzohet për në Qendrën

<ul style="list-style-type: none"> ● Plani dhe programi vjetor i punës së shkollës ● Ditar për përcjelljen e bashkëpunimit të shërbimit pedagogjik me: prindë, arsimtarë dhe nxënës 	<p>Medicinale në Tetovë apo në Shkup. Me nxënës të këtyllë shkolla nuk organizon ndonjë mësim plotësues me çrast do të bëhet kompensimi i ditëve të humbura mësimore, edhe pse disa herë kemi patur raste të këtylla.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Edhe pse ka raste të shpeshta të të shfaqurit të "simpatisë" në raportet ndërgjinore, të cilat aty këtu, rezultojnë edhe me "dashuri" të parakohëshme, shkolla zakonisht merret me këtë problematikë në nivel të udhëheqësve të paraleleve, sidomos në orë të klasës, madje edhe në nivel të drejtorisë dhe shërbimit pedagogjik, duke organizuar këshillime, konsultime, tema pedagogjike për edukimin dhe parandalimin e keqedukimit; - Mjetet e teknologjisë informative, si: kompjuterë, pajisje elektronike për rrjetin e internetit, shtypësit, foto-kopja etj. , shkolla i ruan në kabinetin e informatikës-të siguruar me derë dhe rrjetë të metaltë;
<ul style="list-style-type: none"> ● Ditar për përcjelljen e bashkëpunimit të shkollës me: prindë. ● Planifikimet e mësimdhënësve ● Protokole për përcjelljen e punës së mësimdhënësve (nga ana e pedagogut dhe drejtorit) 	<p style="text-align: center;">IV.3. Ndihma adekuate</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për punën e shkollës dhe suksesit, prindërit, informacionet mund t'i marrin përmes takimeve individuale e grupe me nxënësit, përmes përfaqësuesve të Këshillit të Prindërve apo kontakteve individuale me prindë (në kohën e pandemisë, zakonisht takimet bëhen onllajn); - Mësimdhënësit përmes temave që kanë të bëjnë me profesione të ndryshme, i trajtojnë ato në kuadër të ndonjë njësie mësimore të lëndëve të caktuara të cilët në kuadër të orës së bashkësisë së klasës (Programi: Shkathtësi jetësore), që shtjellohen në njësi të caktuara për orientim profesional të nxënësve dhe me anketimet e nxënësve të klasave të IX-ta, nga ana e pedagogut të shkollës për zgjedhjen e profesionit bëhet edhe përcaktimi për në shkollën e mesme të preferuar. Në këtë mënyrë i'u sqarohen edhe mundësitë dhe kapacitetet që disponojnë nga të cilët do të varen edhe rezultatet dhe sukseset në punën apo shkollimin e mëtejme; - Shkolla nuk ka shërbim adekuat profesional që do të merrej sistematikisht me problematikën e orientimit profesional të nxënësve;
<ul style="list-style-type: none"> ● Programi vjetor i punës së shkollës (drejtorit dhe shërbimit pedagogjik) ● Librat amëz të shkollës 	<p style="text-align: center;">IV.4. Përcjellja (ndjekja) e përparimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkolla përparimin e nxënësve e përcjell duke bërë vëzhgime, hospitime, kontrollime, analiza, hulumtime të ndryshme, nxjerrjen e përfundimeve dhe dhënien e propozimave për evidentimin e mangësive dhe vështirësive në rrjedhën e procesit mësimor; - Këto evidentime u prezantohen mësuesve, nxënësve dhe prindërve të cilët një numër i konsiderueshëm nuk u përkushtohen me aq seriozitet; - Për kalimin e nxënësve nga shkolla jonë në ndonjë shkollë tjetër dhe anasjelltas, aplikohet evidencë e ashtuquajtur Fletëshpërngulje, por për disa nxënës hasim vështirësi sepse nuk mund të marrim informata kthyesë, sidomos për disa që shkojnë (transferohen) në botën e jashtme me familjet e tyre; - Në mungesë të këtyre të dhënave të shënuara, shkolla bën vetëm çregjistrimin e tyre dhe evidentimin nga ana e një ditari të improvizuar.

Vetevaluimi

Metodat e shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave																							
(pyetësorë, anketa, vëzhgime)																							
Metoda dhe teknika tjera të shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave	Subjektë të kyçur në mbledhjen e informacioneve vijuese	Informacionet e mbledhura																					
<ul style="list-style-type: none"> ● Anketa me nxënës 	<p style="text-align: center;">Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga nxënësit</p>	<p>Në pyetjen: A thua shkolla i mbështet nevojat emocionale dhe sociale të nxënësve? Nga të anketuarit, 70% e tyre mendojnë se PO), ndërsa 30% e tyre: JO.</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; text-align: center;"> <thead> <tr> <th style="width: 15%;">Nxënës</th> <th style="width: 5%;">M</th> <th style="width: 5%;">F</th> <th style="width: 5%;">GJ</th> <th style="width: 5%;">PO</th> <th style="width: 5%;">%</th> <th style="width: 5%;">J O</th> <th style="width: 5%;">%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>26</td> <td>26</td> <td>52</td> <td>36</td> <td>70</td> <td>16</td> <td>30</td> </tr> </tbody> </table>						Nxënës	M	F	GJ	PO	%	J O	%		26	26	52	36	70	16	30
Nxënës	M	F	GJ	PO	%	J O	%																
	26	26	52	36	70	16	30																
<ul style="list-style-type: none"> ● Anketa me mësimitdhënës 	<p style="text-align: center;">Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga mësimitdhënësit</p>	<p>Në pyetjen: A evidentohet përparimi i nxënësve? 36 (90%) e tyre mendojnë se PO), ndërsa 4 (10%) e tyre deklarojnë të kundërtën.</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; text-align: center;"> <thead> <tr> <th style="width: 15%;">Mësimitdhënës</th> <th style="width: 5%;">GJ</th> <th style="width: 5%;">PO</th> <th style="width: 5%;">%</th> <th style="width: 5%;">JO</th> <th style="width: 5%;">%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>40</td> <td>36</td> <td>90</td> <td>1</td> <td>10</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në pyetjen: A thua nxënësit me probleme shëndetësore (fizike, psiko - emocionale) vështirësojnë procesin e gjithëmbarshtëm mësimit, shumica prej tyre deklarojnë se kjo paraqet PROBLEM.</p>						Mësimitdhënës	GJ	PO	%	JO	%		40	36	90	1	10				
Mësimitdhënës	GJ	PO	%	JO	%																		
	40	36	90	1	10																		
<ul style="list-style-type: none"> ● Pyetësor për prindë 	<p style="text-align: center;">Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga prindërit</p>	<p>Nga 52 prindë të anketuar (të fëmijëve të shkollës qendrore dhe periferike), 90% e tyre mendojnë se shkolla i informon për shëndetin, suksesin dhe zhvillimin e fëmijëve, ndërsa 10% kanë mendim të kundërt.</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; text-align: center;"> <thead> <tr> <th style="width: 15%;">Prindë</th> <th style="width: 5%;">GJ</th> <th style="width: 5%;">PO</th> <th style="width: 5%;">%</th> <th style="width: 5%;">JO</th> <th style="width: 5%;">%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>52</td> <td>47</td> <td>90</td> <td>5</td> <td>10</td> </tr> </tbody> </table>						Prindë	GJ	PO	%	JO	%		52	47	90	5	10				
Prindë	GJ	PO	%	JO	%																		
	52	47	90	5	10																		
<ul style="list-style-type: none"> ● Bisedë me drejtorin e shkollës 	<p style="text-align: center;">Ekipi për mbledhjen e të dhënave</p>	<p>Para fillimit të vitit mësimit plotësohen kushtet për fillimin normal të viti shkollor. (Në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2019/2020 dhe në vitin shk. 2020/2021 intensivisht u punua në plotësimin e kushteve për mësimit me prezence fizike dhe kushtet tekniko-teknologjike për mësimitdhënie onllajn); Prindërit rregullisht informohen me aktivitetet që duhet të ndërmerren në vitin shkollor në vijim. Të gjithë nxënësit rregullisht kyçen në procesin mësimit, madje në situatën e krijuar me pandeminë edhe kyçjen e nxënësve në mësimit onllajn (nga klasa IV – IX-të);</p>																					

Vetevaluimi

Rezultatet e përmbledhura:

Anët e forta:

- Para fillimit të vitit të ri shkollor, rregullisht krijohen të gjitha kushtet e mundshme për realizimin e mësimin;
- Nga ana e ekipit profesional të shkollës, bëhet identifikimi i nxënësve me nevoja të veçanta;
- Rregullisht bëhet vaksinimi i nxënësve, po ashtu edhe dezinfektimi dhe deratizimi i hapësirave mësimore konform protokollit për menaxhim me pandeminë;
- Informimi i rregullt i prindërve me aktivitetet të cilat zhvillohen në shkollë;
- Organizimi i aktiviteteve për kyçjen e drejtë të të gjithë nxënësve në procesin mësimor, varësisht nga nevojat e vet nxënësve.

Anët e dobta:

- Bashkëpunim i pamjaftueshëm me institucionet profesionale për identifikimin dhe ndërmarrjen e masave preventive për fëmijët me nevoja të veçanta;
- Mungesa e punëtorëve profesionalë (psikolog, defektolog, psikiatër) në shkollë, për punë me fëmijët me nevoja të veçanta;

Analizë e rezultateve

Evaluum më detal i kësaj sfere: Përkrahja (mbështetja) e nxënësve

Para fillimit të vitit të ri mësimor, sigurohen kushte optimale për realizimin e punës normale mësimore me nxënës, duke i inkuadruar edhe ata me nevoja të veçanta.

Në shkollën tonë, sigurohen kontrollime sistematike (kontrollime të gojës dhe dhëmbëve) dhe vaksinime të rregullta të nxënësve në Ambullantën shëndetësore në Tearcë, madje në Tetovë, dhe, po qe se identifikohet ndonjë nxënës me probleme serioze shëndetësore, udhëzohet për trajtim adekuat të mëtutjeshëm.

Për problemet e nxënësve si dhe suksesin dhe përparimin e tyre në shkollë, prindërit informohen rregullisht.

Në mënyrë permanente, nga të gjithë subjektët e shkollës pretendohet në dhënien e mbështetjes së nxënësve, sidomos nxënësve me nevoja të veçanta.

Mësimdhënësit përgatisin raporte tremujore për paralelen e vet, të cilat mund të lexohen nga të gjitha palët, sipas kërkesës së tyre.

Këto raporte dhe analiza të përgatitura për paralele të veçanta dorëzohen për mbikëqyrje në shërbimin profesional dhe mund t'i shikojnë të gjithë të interesuarit.

Rezultatet nga këto analiza mund të shfrytëzohen për përmirësimin e procesit edukativo - arsimor.

Aktivitetet e ardhshme:

Sferat prioritare të sferës së katër, të cilat mund të përfshihen në Planin zhvillimor të shkollës

- Trajnim i mësimdhënësve për aplikimin e formave dhe metodave bashkëkohore të punës mësimore edhe me nxënës me nevoja të veçanta;
- Përforcimi i bashkëpunimit të shkollës me institucione profesionale për identifikimin dhe marrjen e masave adekuate në lidhje me nxënësit me nevoja të veçanta;
- Sigurimi dhe adaptimi i një lokali (hapësire) për dhënien e ndihmës së parë.

Përpunuan:

1. Hamije Zilbeari - koordinatore,
2. Enver Husmani (mësimdhënës) - anëtar,
3. Drita Mehazi (mësimdhënëse) - anëtare,
4. Shqipe Idrizi (mësimdhënëse) - anëtare, dhe
5. Burim Baftjari (këshilli i prindërve) - anëtar;

SFERA: V. ATMOSFERA SHKOLLORE

NIVELI I REALIZIMIT: SHUMË MIRË

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave	
Dokumentat e azhurnuara	Informacionet e mbledhura:
<ul style="list-style-type: none"> ● Plani dhe programi vjetor i punës së shkollës ● Proçesverbale nga takimet individuale me prindë ● Ditarët shkollor (regjistrat) 	<p>V.1. Atmosfera shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga përcjellja e procesit të gjithëmbarshtëm edukativo -arsimor nga ana e shërbimit pedagogjik, madje edhe nga ana e Komisionit për vlerësim, veçmas në segmentin e raporteve ndërkolegiale në relacionin mësimdhënës - nxënës dhe nga bisedimet dhe anketimet me mësues, nxënës, prindë e subjektë tjerë, kemi grumbulluar të dhëna të cilat determinojnë një konstatim apodiktiv si vijon: Raportet apo marrëdhëniet në relacionin: mësimdhënës - nxënës dhe anasjelltas janë në një nivel mjaftë interkomunikative ,por ndonjëherë (kur është në shprehje relacioni: mësimdhënës - nxënës) shprehen tendenca imponimi të një edukimi autoritativ nga ana e disa arsimitarëve. - Kur bëhet fjalë për raportet ndërgjinore të nxënësve, shpesh shprehen tendenca të “dominimit fizik” të disa nxënësve të gjinisë mashkullore ndaj atyre femërore, karakteristikë e cila gjenezën e kanë në marrëdhëniet patriarkale të mjedisit ku gjendet shkolla; - Të prirur nga indikacionet e patriarkalizmit, mentalitetit ekstensiv të mbarsur me primesa paragjykmore të disa familjeve nga të cilat vijnë edhe nxënësit e kësaj shkolle, ndodh shpesh që nxënësit me pengesa në zhvillimin fizik por edhe mental, të bëhen objekt talljeje dhe përçmimi në shkollë, por edhe në shoqëri. Për këtë arsye, është më se e domosdoshme puna profesionale me këta nxënës, por edhe me familjet nga të cilat rrjedhin ata. Prandaj, ndihma e institucioneve adekuate dhe shoqatave të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare është e mirëseardhur; - Në lidhje me sjelljen dhe disiplinën në shkollë janë evidente probleme të ndryshme ku më prezente janë disa veprime aberante të disa nxënësve si: vonesa për në mësim, mosrespektimi i rendit shtëpiak të shkollës etj. Shkolla në mënyrë të vazhdueshme po punon në amortizimin e këtyre manifestimeve dhe problemeve të paraqitura, qoftë nga ana e mësimdhënësve në kuadër të orëve të bashkësisë së klasës, të këshillit të arsimitarëve dhe nga ana e shërbimit pedagogjik apo nga ana e drejtorisë së shkollës. Për rastet më drastike, Këshilli i arsimitarëve shqipton edhe masa pedagogjike, kurse në bashkëpunim me Këshillin e prindërve, Këshillit të B. L. dhe Këshillit të shkollës - pronarëve të kafiterive përreth shkollës, të cilët shesin edhe gjëra që dëmtojnë shëndetin e fëmijëve iu është paraqitur vërejtje me shkrim; - Shkolla gjithnjë pretendon të jetë e hapur për personat e interesuar për informim rreth punës dhe rrjedhën e procesit edukativo - arsimor, përkundër inercionit të shprehur nga ana e disa individëve (mësimdhënësve). Bashkëpunimi me këta faktorë apo subjektë të jashtëm që i përmendëm shtrihet përmes kontakteve individuale apo grupore të parapara edhe me Programin e punës së shkollës;

V.2. Promovimi i arritjeve	
<ul style="list-style-type: none"> ● Plani dhe programi i pedagogut të shkollës ● Ditarë shkollor ● Plani dhe programi vjetor i punës së shkollës ● Ditar për përcjelljen e bashkëpunimit të shërbimit pedagogjik me: prindë, arsimtarë dhe nxënës ● Plani dhe programi vjetor i punës së shkollës 	<p>- Pa ndonjë dallim në aspektin e ndryshimeve gjinore, fizike e intelektuale, shkolla bën prezentimin e rezultateve të nxënësve në forma të ndryshme nëpërmjet takimeve me prindë apo konfirmimet e suksesit në gjysmëvjetor dhe fund të vitit përmes formës elektronike, përmes informimeve me shkrim, garave shkollore të organizuara në kuadër të lëndëve të ndryshme mësimore, organizimin e programeve artistike apo ndonjë manifestimit me rastin e shënimit të ndonjë date të rëndësishme me karakter kulturor, historik, shpalljen e punimeve më të mira të nxënësve, nxënësve të dalluar, klasa e dalluar etj. Një anë të dobët të shkollës paraqet trajtimi jo adekuat ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara në mësim, pasi që ajo nuk është në gjendje dhe në mënyrë profesionale të bëjë inkuadrimin e tyre në këto trende, duke patur parasysh edhe nivelin ekstensiv kulturor, social e arsimor të prindërve (familjeve) nga të cilat vijnë, si dhe mungesën e përkrahjes institucionale dhe profesionale të organeve të shtetit në këtë drejtim. Kështu, nga anketa e realizuar me mësimdhënës në lidhje me prononcimin e tyre në lidhje me Mësimin inkluziv (Përfshirjen e fëmijëve me nevoja të vecanta në mësimin e rregullt), kemi fituar këto të deklarime: “Kur bëhet fjalë për përkujdesjen e shoqërisë për këtë kategori fëmijësh, rol të veçantë duhet të luajë shteti, i cili duhet të tregojë një interesim serioz në këtë drejtim, kështu që kjo mund të jetë edhe një stimulim më tepër që edhe shkolla të kompletohet me kuadër profesional, por edhe me mjete dhe inventar të destinuar për këtë qëllim, sepse nuk mjafton vetëm vullneti i mirë në këtë drejtim”;</p> <p>“Pa inkuadrimin apo inkorporimin e institucioneve adekuate nuk mund të ketë sukses në këtë drejtim, sepse nuk mjafton vetëm empatia e shprehur dhe manifestimet emocionale tjera të dhimbsurisë për ta”;</p> <p>“Është shumë humane që në suaza të mundësive tona si mësimdhënës, që përmes aktiviteteve tona të planifikuara mirë, të mund të pretendojmë t’u ndihmojmë këtyre fëmijëve dhe, për ta bërë në mënyrë sa më profesionale këtë, lypset përkrahja serioze dhe këmbëngulëse e institucioneve simotra të shtetit, e, sidomos të ekipeve (qoftë edhe mobile) profesionale për këtë qëllim.</p> <p>- Shkolla me prindërit komunikon përmes kontakteve individuale e grupe në nivelet: mësimdhënës - prindë, shërbim pedagogjik – prindë (këshillim me prindë) dhe, drejtoria – prindë - nxënës etj. Ka raste të komunikimit me shkrim apo me telefon apo e-mail. Ata, shpeshherë marrin informacione për suksesin dhe sjelljen e fëmijëve të tyre, problemet dhe fenomenet negative që paraqiten në punën edukativo - arsimore në shkollë, për kuadrin arsimor, mënyrën e realizimit të punës së mësimdhënies dhe mësimnxënies, për A.J.M., projektet që implementon shkolla, madje me infrastrukturën ligjore e statutare të saj e k.m.r.</p> <p>- Në mënyrë të vazhdueshme shkolla mundohet të mbajë koherencën e bashkëpunimit edhe me afaristë të B.V. dhe komunës, qoftë nëpërmjet organizimit të takimeve, shtruarjes së kërkesave apo projekteve të ndryshme për nevojat e shkollës etj. Por, meqë vet shkolla gjendet në një mjedis rural, madje edhe vet qendra komunale është komunë rurale, potencialet dhe kapacitetet ekonomike janë</p>

V e t e v a l u i m i

	<p>shumë të vogla, dhe standardi i të ardhurave të prindërve ku graviton shkolla është i ulët.</p> <p>- Shkolla fillore komunale: “Eqrem Çabej” shtrin bashkëpunimin edhe me shkollat tjera të komunës, por edhe më gjërë, qoftë përmes kontakteve në nivel të vet mësimdhënësve, aktiveve profesionale, qoftë përmes aktivitetit të pedagogëve apo drejtorëve të shkollave (në organizimin e manifestimeve të ndryshme, garave sportive, qoftë përmes formave më të sofistikuar, siç është interneti).</p>
<ul style="list-style-type: none"> ● Ditar për përcjelljen e bashkëpunimit të shkollës me prindë. 	<p style="text-align: center;">V.3. Barazi dhe drejtësi</p> <p>- Duke u bazuar në aktet ligjore të Ligjit për arsim fillor, Statutin e shkollës, Konventat dhe deklaratën Ndërkombëtare të të drejtave dhe Lirive të Fëmijëve, madje edhe Rregulloret e shumta të shkollës, kjo e fundit, angazhohet në trajtimin e barabartë dhe të paanshëm të fëmijëve pa marrë parasysh përkatësinë gjinore, etnike dhe nevojat e veçanta arsimore. Për këtë arsye, në veprimtarinë e saj ky institucion edukativo - arsimor, si në shkollën qendrore (ku mësimi zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe), po ashtu edhe në atë periferike (ku mësimi zhvillohet në dy gjuhë: shqip dhe maqedonisht) - mundohet që për çdo vit të sigurojë kushte të barabarta teknike e kadrovike - profesionale të njëjta dhe të barabarta për të gjithë këta nxënës, edhe pse ky realitet në prizmin e nxënësit shihet ndryshe.</p>
<ul style="list-style-type: none"> ● Programi vjetor i punës së shkollës (drejtorit dhe Këshillit të shkollës) 	<p style="text-align: center;">V.4. Marrëdhënie partneriteti me prindërit, me Bashkësinë Lokale dhe komunitetin afarist</p> <p>- Në nxitjen e prindërve për kyçjen në arsimimin e fëmijëve të tyre, shkolla pos takimeve individuale dhe grupe organizon edhe mbledhje prindore ku ata inkurajohen për një kujdes, interesim dhe intensifikim edhe më të madh të bashkëpunimit me shkollën. Në nivel të Këshillit të Prindërve, shërbimi pedagogjik, përkatësisht pedagogu i shkollës shpesh organizon këshillime me prindë, madje edhe punëtori metodike (punë në grupe) me qëllim që prindërit të informohen me të drejtat e tyre për informim real me rrjedhën e punës edukative-arsimore dhe jetën e shkollës në përgjithësi. Meqë struktura dhe gjendja kulturo - arsimore e prindërve apo familjeve të nxënësve të këtij vendbanimi është mjaft ekstensive (ku 70% e tyre janë me arsim fillor e 20% me arsim të mesëm dhe 10% me arsim të lartë), është shumë vështirë të arrihet një bashkëpunim më kooperativ dhe të ndërsjellë në këtë segment. Ndërkaq, shkolla nxit prindërit të përfshihen në punën e shkollës vetëm në suazat e niveleve formale të vendimit. Komunikimi i shkollës me prindërit “zbret” në mbajtjen e dy mbledhjeve prindore në një gjysmëvjetor, por ka raste kur mbahen mbledhje apo takime individuale me prindë. Informatat që kanë të bëjnë me punën e shkollës janë shumë të shkurtra dhe të paqarta për prindërit. Ka prindër të cilët mendojnë se nuk janë të mirëpritur nga një pjesë e të punësuarve në shkollë.</p> <p>- Shkolla realizon bashkëpunim me Bashkësinë vendore në suaza të obligimeve ligjore formale (edhe atë përmes ndonjë takimi të drejtorisë së shkollës me anëtarë apo kryetar të B.V.) dhe ka disa raste kur bëjnë ndonjë projekt dhe organizojnë ndonjë manifestim të përbashkët;</p> <p>- Shkolla nuk bashkëpunon me komunitetin afarist për realizimin e mësimit praktik, por ka raste të ndonjë bashkëpunimi sporadik me ndonjë shoqatë të sektorit joqeveritar.</p>

Vetevaluimi

Metodat e shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave																							
(pyetësorë, anketa, vëzhgime)																							
Metoda dhe teknika tjera të shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave	Subjektë të kyçur në mbledhjen e informacioneve vijuese	Informacionet e mbledhura																					
<ul style="list-style-type: none"> Anketa me nxënës 	<p>Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga nxënësit</p>	<p>Në pyetjen: A thua raportet ndërmjet nxënësve bazohen në respektimin e ndërsjelltë? 70% e tyre mendojnë se PO), ndërsa 30% e tyre: JO.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nxënës</th> <th>M</th> <th>F</th> <th>GJ</th> <th>PO</th> <th>%</th> <th>J O</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>26</td> <td>26</td> <td>52</td> <td>36</td> <td>70</td> <td>16</td> <td>30</td> </tr> </tbody> </table>						Nxënës	M	F	GJ	PO	%	J O	%		26	26	52	36	70	16	30
Nxënës	M	F	GJ	PO	%	J O	%																
	26	26	52	36	70	16	30																
<ul style="list-style-type: none"> Anketa me mësime 	<p>Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga mësime</p>	<p>Në pyetjen: A i mbështet shkolla të gjithë mësime njësoj? 85% e tyre mendojnë se PO, ndërsa 15% e tyre deklarojnë të kundërtën.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Mësime</th> <th>GJ</th> <th>PO</th> <th>%</th> <th>JO</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>40</td> <td>36</td> <td>85</td> <td>4</td> <td>10</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në pyetjen: A i mbështet shkolla të gjithë nxënësit njësoj? Shumica prej tyre 90% deklarojnë PO, ndërsa 10% deklarojnë të kundërtën.</p>						Mësime	GJ	PO	%	JO	%		40	36	85	4	10				
Mësime	GJ	PO	%	JO	%																		
	40	36	85	4	10																		
<ul style="list-style-type: none"> Pyetësor për prindë 	<p>Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga prindërit</p>	<p>Nga 52 prindë të anketuar (të fëmijëve të shkollës qendrore dhe periferike), në pyetjen: A i mbështet shkolla të gjithë nxënësit njësoj? -75% e tyre mendojnë se shkolla i trajton të gjithë nxënësit njësoj, ndërsa 25% deklarojnë të kundërtën.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Prindë</th> <th>GJ</th> <th>PO</th> <th>%</th> <th>JO</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>52</td> <td>39</td> <td>75</td> <td>13</td> <td>25</td> </tr> </tbody> </table>						Prindë	GJ	PO	%	JO	%		52	39	75	13	25				
Prindë	GJ	PO	%	JO	%																		
	52	39	75	13	25																		
<ul style="list-style-type: none"> Bisedë me prindë 	<p>Ekipi për mbledhjen e të dhënave</p>	<p>Nga prindërit, rregullisht marrim informacione se shumica prej tyre nuk bashkëpunojnë me shkollën për arsye të shumta, si: puna private, puna në shtetet e jashtme, zënia me punë dhe probleme shtëpiake “më të rëndësishme”, etj.</p>																					
<ul style="list-style-type: none"> Bisedë me përfaqësues të Bashkësive Lokale Sllatinë dhe Neproshten 	<p>Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga Bashkësitë Lokale</p>	<p>Nga biseda me përfaqësues të B. L. erdhëm deri te përfundimi se, shkolla relativisht bashkëpunon me B.V. në fjalë dhe me prindërit, edhe pse kërkohet një angazhim dhe gatishmëri më intensive për një bashkëpunim më efikas.</p>																					
<ul style="list-style-type: none"> Bisedë me drejt. dhe kryetarin e Këshillit të Shkollës 	<p>Ekipi për mbledhjen e të dhënave</p>	<p>Shkolla pretendon të bashkëpunojë me afaristë (të paktë që ka në këtë Bashkësi Lokale) dhe ata në një farë mënyre ndihmojnë në ndonjë formë shkollën.</p>																					

Rezultatet e përmbledhura:

Anët e forta:

- Posedimi i Kodit të sjelljes me të cilin janë përcaktuar parimet dhe rregullat e sjelljes së të gjitha strukturave në shkollë;
- Ekzistenca e bashkëpunimit midis të punësorëve, nxënësve dhe të tjerëve të involvuar në procesin edukativo - arsimor;
- Hapja e shkollës karshi subjektëve të jashtëm të cilët janë të interesuar për mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor;
- Ndihma e rregullt dhënë mësimit dhe nxënësve pa dallim etnie, gjinie dhe proveniencë sociale;
- Pretendimi për bashkëpunim të rregullt të shkollës me prindë për zgjidhjen e problemeve që paraqiten në shkollë;
- Pretendimi për bashkëpunim më të dendur shkollës me B.V dhe afaristë të ndryshëm.

Anët e dobta:

- Shkolla posedon politikë të nxitjes së kuadrit arsimor dhe të nxënësve për pjesëmarrje dhe arritje të sukseseve në gara lokale, rajonale e republikane, por nuk ka gjithaq sistem të zhvilluar për shpërblime të nxënësve dhe mësimit dhe nxënësve që kanë arritur rezultate në to;
- Mospërfshirja e mjaftueshme e prindërve në projekte dhe programe të cilat kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimit;

Analizë e rezultateve

Evaluum më detal i sferës: ATMOSFERA SHKOLLORE

Para fillimit të vitit të ri mësimor, sigurohen kushte optimale për realizimin e punës normale mësimore me nxënës, duke i inkuadruar edhe ata me nevojë të veçanta. Për problemet e nxënësve si dhe suksesin dhe përparimin e tyre në shkollë, prindërit informohen rregullisht. Në mënyrë permanente, nga të gjithë subjektët e shkollës pretendohet në dhënien e mbështetjes së nxënësve, sidomos nxënësve me nevojë të veçanta. Mësimit dhe nxënësve përgatishin raporte tremujore për paralelet e vet, të cilat mund të lexohen nga të gjitha palët, sipas kërkesës së tyre. Këto raporte dhe analiza të përgatitura për paralele të veçanta dorëzohen për mbikëqyrje në shërbimin profesional dhe mund t'i shikojnë të gjithë të interesuarit. Rezultatet nga këto analiza mund të shfrytëzohen për përmirësimin e procesit edukativo-mësimor.

Aktivitetet e ardhshme:

Sferat prioritare të sferës së pestë, të cilat mund të përfshihen në Planin zhvillimor të shkollës

- Krijimi i aktiveve të disa mësimit dhe nxënësve në projekte inovative në kontekst të përmirësimit të atmosferës në shkollë;
- Intensifikimi i kontakteve dhe bashkëpunimeve edhe më të ngjeshura me B.V., V.L. si dhe me drejtues të kompanive afariste lokale dhe më gjërë;
- Përforsimi i kontakteve dhe bashkëpunimeve me tregun e punës;
- Sigurimi i mjeteve për vazhdimin e bashkëpunimeve me shkollën simotra në vend dhe diasporë;

Përpunuan:

1. Zemri Idriji (mësimit dhe nxënësve) - koordinator,
2. Skender Memeti (mësimit dhe nxënësve) - anëtar,
3. Hiriye Rustemi (mësimit dhe nxënësve) - anëtare,
4. Valbona Salihi (mësimit dhe nxënësve) - anëtare,
5. Nehat Memeti (këshilli i prindërve)- anëtar;

SFERA VI: RESURSET

NIVELI I REALIZIMIT: SHUMË MIRË

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave	
Dokumentat e azhurnuara	Informacionet e mbledhura:
<ul style="list-style-type: none"> Programi vjetor i punës së shkollës 	<p style="text-align: center;">VI.1. Akomodimi dhe kapacitetet hapësinore</p> <p>- Shkolla fillore komunale: “Eqrem Çabej”-Sllatinë posedon dy objekte shkollore, shkollën qendrore në f. Sllatinë dhe atë periferike në f. Neproshten. Shkolla qendrore disponon me 12 mësonjëtoje me nga 56 m², 1 sallë për mësimdhënësit (63 m²), hapësira për zyra për shërbimet adekuate (3x16 m²), kabinet të informatikës (40 m²), bibliotekën me 56 m², 1 magazinë (24 m²), kotllarë (24 m²), hapësira për nyje sanitare, sallë joadekuate për fizkulturë (190 m²), korridore me 240 m². Oborri i shkollës që përfshin 1200 m², prej të cilit, 600 m² shfrytëzohen për terrene sportive (i asfaltuar) dhe aneksi përdhes me një lokal me hapësirë 30 m² dhe nyje sanitare.</p> <p>Shkolla në f. Neproshten ka 6 mësonjëtoje x 48 m², sallë fikulture (210 m²), korridor (150 m²), oborri (1200 m²). Në lagjen maqedone janë të vendosura dy baraka, ku mësimi zhvillohet në gjuhën maqedone (2 paralele të kombinuara) me nxënës të nacionalitetit maqedonas.</p>
<ul style="list-style-type: none"> Raporte statistikore 	<p style="text-align: center;">VI.2. Mjetet dhe materialet mësimore</p> <p>- Nga mjete mësimore, në shkollën qendrore dhe periferike ka kompjuterë në çdo klasë, për drejtorinë e shkollës, videoprojektorë në çdo klasë, dhe aparate fotokopjuese.</p> <p>- Shkolla disponon me literature profesionale dhe mjete mësimore të cilat pjesërisht përputhen me rrjedhat bashkëkohore të nevojshme. Ajo i përcakton nevojat për mjete mësimore dhe mjete ndihmëse, por nuk ka sistem për ndjekjen e përdorimit dhe mirëmbajtjes së tyre.</p>
<ul style="list-style-type: none"> Të dhëna bazike nga dosjet e të punësuarve të shkollës 	<p style="text-align: center;">VI.3. Sigurimi i kuadrit të nevojshëm</p> <p>- Për realizimin e punës mësimore dhe veprimtarive tjera, shkolla ka të siguruar kuadër adekuat. Në vitin mësimor, 100% e mësimdhënësve janë me arsimim adekuat, prej tyre, 42 mësimdhënës, 29 femra (69%) dhe 13 meshkuj (31%). Nga ky kuadër mësimdhënësish, 7 janë me shkollë të lartë (17%) dhe 35 janë me fakultet (83%), prej ku konstatohet se në përgjithësi kuadri me kualifikim superior është dukshëm më i konsiderueshëm.</p> <p>- Në shkollën në fjalë i tërë personeli është i rregullt në punë. Mungesa nga puna arsyetohet me lajmërimin paraprak të drejtorit të shkollës. Përcjellja e prezencës dhe rregullshmërisë së personelit arsimor dhe teknik në punë bëhet përmes kutisë elektronike (me kartelë) dhe kujdestarisë nga ana e mësimdhënësve dhe shënimet në listën e kujdestarisë që e udhëheqin vet arsimtarët kujdestarë.</p>

V e t e v a l u i m i

<ul style="list-style-type: none"> ● Evidenca e drejtorit ● Evidenca e pedagogut 	VI.4 Ndjekja e nevojave zhvillimore të kuadrit të mësimdhënësve
<ul style="list-style-type: none"> ● Evidenca e drejtorit ● Evidencat financiare të shkollës 	VI.5 Puna financiare e shkollës

Nga përcjellja e realizimit të orëve mësimore (përmes hospitimeve pedagogjike), shkolla identifikon nevojat e mësimdhënësve për zhvillim profesional, por jo në mënyrë sistematike kur bëhet fjalë për përcjelljen e punës pedagogjike të arsimtarëve fillestarë, për të cilët organizohet punë mentoriale nga ana e shkollës.

Procedurat për punën financiare që i zbaton shkolla janë në përputhje me normat ligjore. Kuadri udhëheqës relativisht ka mirëkuptim për mekanizmat që mund t'i shfrytëzojë për arritjen e mjeteve plotësuese financiare. Përparësitë buxhetore nuk janë gjithmonë të lidhura dhe nuk e pasqyrojnë përparësitë dhe qëllimet arsimore të shkollës.

Buxheti shfrytëzohet për qëllime afatshkurta ose përparësi të cilat janë të lidhura edhe me përmirësimin e cilësisë së mëimit dhe mësimdhënies si dhe me zhvillimin e përgjithshëm të shkollës.

Metodat e shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave (pyetësorë, anketa, vëzhgime)

Metoda dhe teknika tjera të shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave	Subjektë të kyçur në mbledhjen e informacioneve vijuese	Informacionet e mbledhura																
<ul style="list-style-type: none"> ● Anketa me mësimdhënës 	<p style="text-align: center;">Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga të punësuarit</p>	<p>Në pyetjen: - A ekzistojnë në shkollë sisteme të mira të mbështetjes dhe përkrahjes së mësimdhënësve (kur ballafaqohen me vështirësi në orë të caktuara mësimore: disiplina, mësimdhënia, mësimnxënia), nga 40 mësimdhënës të anketuar, 36 (90%) janë përgjigjur me PO, ndërsa 4(10%) me JO.</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th>Mësimdhënës</th> <th>GJ</th> <th>PO</th> <th>%</th> <th>JO</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">40</td> <td style="text-align: center;">36</td> <td style="text-align: center;">90</td> <td style="text-align: center;">4</td> <td style="text-align: center;">10</td> </tr> </tbody> </table>	Mësimdhënës	GJ	PO	%	JO	%		40	36	90	4	10				
Mësimdhënës	GJ	PO	%	JO	%													
	40	36	90	4	10													
<ul style="list-style-type: none"> ● Anketa me nxënës 	<p style="text-align: center;">Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga nxënësit</p>	<p>Nga gjithsejt: 100 nxënës të anketuar 85% e tyre mendojnë se mësonjëtorët ku ata mësojnë, i plotësojnë nevojat e tyre, ndërsa 15% e tyre deklarojnë të kundërtën.</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th>Nxënës</th> <th>M</th> <th>F</th> <th>GJ</th> <th>PO</th> <th>%</th> <th>J O</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">26</td> <td style="text-align: center;">26</td> <td style="text-align: center;">52</td> <td style="text-align: center;">44</td> <td style="text-align: center;">85</td> <td style="text-align: center;">8</td> <td style="text-align: center;">16</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga po aq numër nxënësish të anketuar, (70%) e tyre konsiderojnë se shkolla ku ata mësojnë është e furnizuar me pajisje dhe mjete mësimore, kundruall 30 %, të cilët mendojnë të kundërtën.</p>	Nxënës	M	F	GJ	PO	%	J O	%		26	26	52	44	85	8	16
Nxënës	M	F	GJ	PO	%	J O	%											
	26	26	52	44	85	8	16											

V e t e v a l u i m i

<ul style="list-style-type: none"> Pyetësor për prindë 	<p>Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga prindërit</p>	<p>Nga 52 prindë të anketuar (të fëmijëve të shkollës qendrore dhe periferike), 85% e tyre u pëlqen puna e shkollës (me kushtet teknike e kadrovike), ndërsa 15% e tyre mendojnë të kundërtën. (Nuk janë të kënaqur me kushtet teknike, por edhe me ato kadrovike).</p>
<ul style="list-style-type: none"> Takime individuale me prindë, nxënës dhe mësimdhënës 	<p>Ekipi për mbledhjen e të dhënave</p>	<p>Mësimdhënësit mendojnë se me kooperimin më të ngjeshur të prindërve në shkollë, mund të ndikohet në lidhje me mënyrën e sigurimit të mjeteve dhe pajisjeve më kualitative mësimore.</p> <p>Një numër i caktuar prindërisht (përfaqësues nga Këshilli i Prindërve të shkollës), mendojnë se mësimdhënësit tregojnë kujdesin e duhur për ruajtjen e mjeteve dhe pajisjeve mësimore.</p> <p>Nxënësit në kë aspekt janë vetkritikë, duke pranuar se një numër i konsiderueshëm i tyre nuk janë të vëmendshëm në ruajtjen e të mirave materiale të shkollës dhe pronës shoqërore të saj.</p>
<ul style="list-style-type: none"> Bisedë me sekretarin e shkollës 	<p>Ekipi për mbledhjen e të dhënave</p>	<p>Sipas nevojave që paraqiten, shkolla sistematikisht siguron materiale harxhuese për nevojat e shkollës, këtë vit shkollor janë siguruar edhe 15 proektorë dhe 9 shtëpiza kompjuterike, për mbajtjen e mësimin online, përshkak të pandemisë (çdo klasë është e pajisur me projektorë). Poashtu në shkollën qendrore dhe në atë periferike ka të siguruar edhe nga një tabelë të mençur (smart tabelë).</p>
<ul style="list-style-type: none"> Bisedë me drejtorin dhe kryetarin e Këshillit SH. 	<p>Ekipi punues</p>	<p>Shkolla për çdo vit sjellë Plan financiar dhe raport për punën financiare me vendim të Këshillit të shkollës. Nga bllok Donacioni që i lëshohet komunës sigurohen mjetet e nevojshme financiare. Regullisht bëhet raport për të hyrat dhe daljet e shkollës. Ndodh që shkolla të sigurojë mjete edhe nga donatorë të ndryshëm dhe shoqata të ndryshme joqeveritare për zhvillimin e procesit edukativo-arsimor.</p>
<ul style="list-style-type: none"> Drejtoria e shkollës 	<p>Ekipi punues</p>	<p>Shkolla maksimalisht angazhohet për sigurimin e kuadrit kualitativ dhe adekuat për një efikasitet më të mirë të punës edukativo - arsimore.</p>

Rezultatet e përmbledhura:

Anët e forta:

- Angazhimi maksimal i shkollës në përmbushjen dhe plotësimin e nevojave imanente të nxënësve dhe të punësuarve;
- Angazhimi permanent i shkollës për sigurimin e kuadrit adekuat dhe kualitativ me qëllim të përmbushjes dhe plotësimin të nevojave dhe kërkesave të nxënësve;
- Të punësuarit e shkollës janë të rregullt dhe përgjegjës në punë;
- Mjetet mësimore që i posedon shkolla janë në dispozicion të mësimeve pa dallime të relacioneve: shkollës qendrore-periferike;
- Shkolla sipas mundësive siguron mjete materiale harxhuese për nevojat e shkollës;
- Drejtori dhe pedagogu, në mënyrë permanente bëjnë përcjelljen e kualitetit të planifikimit të punës së mësimeve dhe shprehin gatishmërinë e tyre për ndihmë profesionale me qëllim të ngritjes së efikasitetit të punës mësimore.

Anët e dobta:

- Nyjet sanitare të jashtë objektit shkollor (në shkollën periferike) dhe domosdoshmëria për ndërtimin e nyjeve sanitare duke pasur qasje direkte nga koridori i shkollës;
- Mossigurimi i mjeteve material-teknike për implementimin e mësimit kabinetik;

Analizë e rezultateve

Evaluum më detal i sferës: RESURSE

Shkolla fillore “Eqrem Çabej” posedon dy objekte shkollore, një në Sllatinë (si shkollë qendrore) dhe një në Neproshten (si shkollë periferike), bashkë me një barakë për mësimin në gjuhën maqedone, por me mungesë të mjeteve të mjaftueshme mësimore, sidomos në shkollën e f. Neproshten.

Në shkollën qendrore mungon salla sportive (punët për ndërtimin e sallës kanë filluar).

Po ashtu mungojnë edhe këndet e fëmijëve (për fëmijët nga klasa e I – V-të).

Mësimeve mendojnë se nuk ekzistojnë Kriteriume të mirëfillta për evaluimin e punës së tyre. Gjendja me infrastrukturën e shkollës (në të dyja shkollat), nuk është në nivelin që po pretendohet.

Rregullshmëria e të punësuarve në shkollës është në nivelin e duhur dhe sipas Rregullores. Shkolla, sipas Statutit dhe Rregullores, organizon kujdestari nga ana e vet mësimeve.

Aktivitetet e ardhshme:

Sferat prioritare të sferës së gjashtë, të cilat mund të përfshihen në Planin zhvillimor të shkollës:

- Intervenim në sanimin dhe fasadimin e mureve të mësonjëtove të të dy objekteve shkollore;
 - Sigurimi i rrjetit më të qëndrueshëm të internetit; si në shkollën qendrore po ashtu edhe në shkollën periferike;
- Sigurimi i mjeteve mësimore për implementimin e mësimit kabinetik.

Përpunuan:

1. Behare Alimi (mësimeve) - koordinatore,
2. Fatime Idrizi (mësimeve) - anëtare,
3. Imer Imeri (mësimeve) - anëtar,
4. Zeqirja Jonuzi (mësimeve) - anëtar,
5. Gajur Salih (këshilli i prindërve) – anëtar

VII. UDHËHEQJA, MENAXHIMI DHE KRIJIMI I POLITIKËS:

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave	
Dokumentat e azhuruara	Informacionet e mbledhura:
<ul style="list-style-type: none"> ● Ligji për Arsim fillor nëntëvjeçar ● Statuti i shkollës dhe rregulloret 	<p style="text-align: center;">VII.1. Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Struktura e administrimit të shkollës përbëhet nga Organi drejtues, Këshilli i shkollës dhe subjektë tjerë – përfaqësues të Këshillit të prindërve dhe Aktivitet profesional. - Këshilli i shkollës përbëhet nga 7 anëtarë (tre arsimtarë, tre përfaqësues nga Këshilli i prindërve, 1 anëtar nga themeluesi: 1. Luan Abdullahi (Kryetar); 2. Emri Ajdini, 3. Shqipe Zaimi, 4. Blerim Neimi, 5. Bujar Jakupi, 6. Burim Baftijari, 7. Arta Idrizi. - Kompetencat e Organit drejtues, por edhe të atij udhëheqës janë të definuara qartë me rregullativat ligjore ekzistuese, të cilat respektohen nga ana e shkollës (me Statutin e shkollës dhe Rregulloren e Këshillit të shkollës). - Këshilli i shkollës rregullisht organizon dhe realizon mbledhje dhe sjell vendime të drejta dhe të rëndësishme. Për çdo takim apo mbledhje, ky forum mba evidencë dhe procesverbal. - Organ udhëheqës i shkollës është drejtori, Lulzim Idrizi. Relativisht, ekzistojnë raporte të mira për zhvillim dhe planifikim ndërmjet organit drejtues dhe atij udhëheqës me organet tjera të shkollës. - Drejtori, rregullisht i informon të punësuarit për vendimet e ndryshme, qoftë përmes kontakteve individuale me udhëheqësit e trupave të shkollës ose përmes Këshillave të arsimtarëve. Për vendimet e sjellura nga ekipi udhëheqës i shkollës, nxënësit informohen përmes kujdestarëve (udhëheqësve) të klasës apo përfaqësuesve të Bashkësisë së klasës dhe Parlamentit të nxënësve.
<ul style="list-style-type: none"> ● Programi vjetor i punës së shkollës ● Evaluimi personal ● Plani zhvillimor i shkollës ● Intervista me drejtorin, shërbimin profesional, mësimdhënësit, prindërit, nxënësit 	<p style="text-align: center;">VII.2. Qëllimi dhe krijimi i politikës së shkollës</p> <ul style="list-style-type: none"> - Qëllimet e shkollës janë në përputhje me qëllimet e politikës arsimore. - Qëllimet kanë fokus sigurimin e cilësisë në mësim. Kuadri, prindërit dhe nxënësit janë të njoftuar me qëllimet, parimet dhe vlerat e shkollës, si dhe me mënyrën e realizimit dhe vlerësimit të tyre, por nuk janë të përfshirë në këto realizime. - Nuk është e qartë se si kontribuojnë qëllimet e caktuara për përmirësimin e arritjeve të nxënësve.
<ul style="list-style-type: none"> ● Evaluimi personal dhe plani zhvillimor i shkollës ● Procesverbale nga mbledhjet e Këshillave të shkollës 	<p style="text-align: center;">VII.3. Planifikimi zhvillimor</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkolla ka plane aksionare për pjesë të synimeve të caktuara. Rëndësia e tyre është e ndarë pjesërisht me mësimdhënësit, nxënësit dhe prindët, kurse shkolla angazhohet t'i marrë parasysh qëndrimet e mësimdhënësit, prindërve dhe nxënësve. - Shkolla intervenon sipas nevojave dhe siguron mjete për përmirësimin e infrastrukturës së shkollës dhe furnizimin e saj me mjete mësimore.

Vetevaluimi

Metodat dhe teknikat e shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave (pyetësorë, anketa, vëzhgime)																							
Metoda dhe teknika tjera të shfrytëzuara për mbledhjen e të dhënave	Subjektë të kyçur në mbledhjen e Informacioneve vijuese	Informacionet e mbledhura																					
<ul style="list-style-type: none"> Anketa me mësimdhënës 	Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga mësimdhënësit	<p>-Në Këshillin e shkollës dhe në drejtorinë e saj, përfshihen në mënyrë adekuate edhe pjesëtarët e gjinisë femërore, që do të thotë se në organet shkollë nuk mungon përfaqësimi i barabartë edhe i gjinisë femërore.</p> <p>- Nga 40 mësimdhënës të anketuar të shkollës (25 M dhe 15 F), 32 (85%) e tyre mendojnë se janë të kyçur në krijimin e politikave të shkollës, sidomos kur bëhen zgjedhje për Këshillin e shkollës , ndërsa 8 (15%) e tyre mendojnë të kundërtën.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Mësimdhënës</th> <th>M</th> <th>F</th> <th>GJ</th> <th>PO</th> <th>%</th> <th>J O</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>25</td> <td>15</td> <td>40</td> <td>32</td> <td>85</td> <td>8</td> <td>15</td> </tr> </tbody> </table> <p>- Për Planifikimin vjetor, përveç që janë përgjegjës Drejtori dhe Këshilli i shkollës, mësimdhënësit gati në përgjithësi mendojnë që edhe ata janë përgjegjës për një aktivitet të këtillë bashkë me shërbimin pedagogjik të shkollës dhe Këshillin e prindërve, sepse pa një kooperim të këtillë nuk mund të parashikohet dhe të paramendohet Planifikimi vjetor, aq më pak kur bëhet fjalë për Aktivitetet jashtëmësimore, sidomos ekskursionet, mësimi zgjedhor, etj.</p>						Mësimdhënës	M	F	GJ	PO	%	J O	%		25	15	40	32	85	8	15
Mësimdhënës	M	F	GJ	PO	%	J O	%																
	25	15	40	32	85	8	15																
<ul style="list-style-type: none"> Anketa me nxënës 	Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga nxënësit	<p>- Në pyetjen: A konsultohet Këshilli i shkollës me nxënësit kur bëhet Plani vjetor i shkollës? Nga gjithsejt: 52 nxënës të anketuar 26 M. dhe 26 F. (nga klasaVI – IX-të), 70 prej tyre (70%) deklarojnë se janë të informuar, ndërkaq 30 (30%) nuk janë të informuar.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nxënës</th> <th>M</th> <th>F</th> <th>GJ</th> <th>PO</th> <th>%</th> <th>J O</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>26</td> <td>26</td> <td>52</td> <td>36</td> <td>70</td> <td>16</td> <td>30</td> </tr> </tbody> </table> <p>- Në lidhje me krijimin e Politikave shkollë, nxënësit deklarohen se janë të kyçur në një aktivitet të këtillë.</p> <p>- Nga 52 nxënës të anketuar 33 (63%) mendojnë se përgjegjës për hartimin e Planit vjetor të shkollës janë drejtori, shërbimi pedagogjik i shkollës dhe ndihmës drejtori.</p> <p>- Gati se qind për qind e nxënësve mendojnë se aktivitetet për planifikim afatgjatë duhet të jenë: sigurimi i mjeteve dhe pajisjeve mësimore, pra ndërtimi i sallës sportive (e cila vetëm se ka filluar të ndërtohet), etj.</p> <p>- Në bisedë me grup të nxënësve, fituam informata se në shkollë organizohen aksione për mbajtjen e higjienës dhe pastërtisë.</p>						Nxënës	M	F	GJ	PO	%	J O	%		26	26	52	36	70	16	30
Nxënës	M	F	GJ	PO	%	J O	%																
	26	26	52	36	70	16	30																
		<p>- Nga 52 prindë të anketuar të fëmijëve të shkollës qendrore dhe periferike), 33 (63%) e tyre mendojnë organ kryesor i udhëheqjes së shkollës është drejtori, ndërsa 19</p>																					

V e t e v a l u i m i

<ul style="list-style-type: none"> ● Pyetësor për prindë 	<p style="text-align: center;">Ekipi për mbledhjen e të dhënave nga prindërit</p>	<p>(37%) e tyre mendojnë se organ kryesor i udhëheqjes së shkollës është Këshilli i shkollës.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prindët e anketuar mendojnë se ekipi udhëheqës i shkollës mban mbledhje të mjaftueshme me Këshillin e prindërve për krijimin e politikave shkollore. - Në pyetjen: A jeni të inkuadruar në krijimin e politikave të shkollës?, nga gjithsejt 52 prindë të anketuar, 37 (72%) e tyre deklarojnë se janë të kyçur, ndërsa 15 (28%) e tyre mendojnë se nuk janë të inkuadruar. <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <tr> <td style="text-align: center;">Prindë</td> <td style="text-align: center;">GJ</td> <td style="text-align: center;">PO</td> <td style="text-align: center;">%</td> <td style="text-align: center;">JO</td> <td style="text-align: center;">%</td> </tr> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">100</td> <td style="text-align: center;">72</td> <td style="text-align: center;">72</td> <td style="text-align: center;">28</td> <td style="text-align: center;">28</td> </tr> </table> <ul style="list-style-type: none"> - Prindët mendojnë se nga ana e Këshillit të shkollës, përveç disa primesave që indicojnë në një bashkëpunim relativisht të mire me disa lëshime të vogla. 	Prindë	GJ	PO	%	JO	%		100	72	72	28	28
Prindë	GJ	PO	%	JO	%									
	100	72	72	28	28									
<ul style="list-style-type: none"> ● Bisedë me drejtorin e shkollës, pedagogun, ● Azhurnimi i raportit nga ana e IRA dhe NJR të BZHA-Tetovë 	<p style="text-align: center;">Ekipi për mbledhjen e të dhënave</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Në bisedë me drejtorin e shkollës u informuam se shkolla posedon instrumente për ndjekjen e përparimit të planifikimit afatgjatë të shkollës, por nevojitet edhe me teper. - Drejtori, këshilltarët pedagogjikë, përfaqësues të inspektoratit për arsim dhe pedagogu i shkollës, në bazë të numrit të caktuar të hospitimeve pedagogjike, konstatojnë se shkolla nuk ka politikë për nxënësit me nevoja të veçanta dhe nuk ka ndihmesë të mjaftueshme dhe përkrahje nga institucione tjera profesionale për punën frytëdhënëse me fëmijët e kësaj kategorie. 												

Rezultatet e përmbledhura:

Anët e forta:

- Në shkollë të gjitha organet dhe këshillat apo komisionet punojnë sipas ligjit për arsim fillor, rregulloret e ndryshme që dalin nga Statuti i shkollës;
- Ekipi punues pretendon të bashkëpunojë në drejtim të këmbimit të ideve dhe në domenin e zgjidhjes së problemeve;
- Ekzistojnë aktivitete të planifikimit vjetor të shkollës për të cilët përgjegjës është drejtori i shkollës si organ udhëheqës;
- Shkolla periferike është e kyçur në strukturat udhëheqëse të shkollës ku ka edhe mësimdhënës përgjegjës;
- Kompetencat dhe detyrat e udhëheqjes dhe administrimit të shkollës janë të definuara qartë dhe ato realizohen sipas Ligjit.
- Shkolla periferike bashkëpunon me bordin udhëheqës të shkollës;
- Aktivitetet për planifikim afatgjatë realizohen në tërësi nga ana e udhëheqjes dhe drejtorisë së shkollës;
- Ka iniciativa për projekte në të cilat prindërit dhe rinia e Bashkësisë lokale, të bëhen partnerë në bashkëpunimin me shkollën;

Anët e dobta:

- Bordi udhëheqës duhet të konsultohet pak me teper me nxënësit kur është në pyetje prurja e vendimeve;
- Përfshirja e instrumenteve për ndjekjen e përparimit të planifikimit afatgjatë me disa mangësi të vogla;

Analizë e rezultateve

Evaluum më detal i sferës: VII. Udhëheqja, menaxhimi dhe krijimi i politikës

Problemet me të cilët ballafaqohen nxënësit, në parim mundohemi t'i zgjidhim në bashkëpunim me të gjithë subjektët e involvuar të shkollës, siç janë: këshilli i shkollës, këshilli i arsimtarëve (me të cilin udhëheq drejtori), këshilli i prindërve, madje edhe bashkësia e nxënësve të shkollës (Parlamenti i nxënësve).

Përgjegjës për organizimin e mbledhjeve është drejtori. Bordi udhëheqës i shkollës, sipas nevojës, për zgjidhjen e problemeve të paraqitura, organizon dhe realizon mbledhje jashtë kohës së punës, dhe gjithnjë pretendon të konsultohet edhe me personelin e shkollës periferike, kur ka të bëjë me Planifikimin vjetor të shkollës.

Nxënësit janë të njoftuar se përgjegjës për planifikimin, por edhe për realizimin e Planit dhe Programit të shkollës, përgjegjës është drejtori i shkollës.

Është karakteristikë e përgjithshme se një numër i vogël prindërisht (në nivel të Këshillit të prindërve të shkollës) marrin pjesë në mbledhje, sidomos prindët e nxënësve të ciklit lëndor.

Për Planifikimin vjetor të punës shkollës, përgjegjës është drejtori dhe Këshilli i shkollës.

Aktivitetet e ardhshme:

Objektivat prioritarë të sferës së shtatë, të cilat mund të përfshihen në Planin zhvillimor të shkollës:

- Të sigurohet trajnim për realizim më të sukseshëm të planifikimit dhe vizionit afatgjatë (për udhëheqësinë e shkollës);
- Trajnim për kyçjen e instrumenteve për përcjelljen e përparimit të planifikimit afatgjatë;
- Sigurimi dhe adaptimi i një lokali (hapësire) për dhënien e ndihmës së pare.

Përpunuan:

1. Lirim Salihi (mësidhënës) - koordinator,
2. Hirem Selimi (mësimdhënëse) - anëtare,
3. Arlinda Elezi (mësimdhënëse) - anëtare,
4. Merita Alimi (mësimdhënëse) - anëtare,
5. Kamber Memedi (këshilli i prindërve) - anëtar.

Komisioni për Vetevaluim:

1. Sirija Etemi bashkëpunëtor profesiona – pedagog;
2. Hamije Zilbehari - ndihmës drejtoreshë;
3. Igballe Bahadini - mësimdhënëse e ciklit klasor;
4. Lirim Salihi - arsimtar lëndor dhe
5. Blerim Neimi - anëtar i Këshillit të prindërve.

Këshilli i shkollës
Kryetari,



/Luan Abdullahi/



Drejtori,



/Lulzim Idrizi/